



Balkan Sunflowers  
Volunteers for Social Reconstruction



# DORACAK

## ME PRAKTIKA TË MIRA NË FUSHËN E FËMIJËRISË SË HERSHME

Prishtinë, 2018



**DORACAK**  
ME PRAKTIKA TË  
MIRA NË FUSHËN E  
FËMIJËRISË SË HERSHME



### **Botues**

Qendra Sociale- Edukative SOS Kopshti, Prishtinë në bashkëpunim me  
Qendra për Arsim e Kosovës- KEC, Balkan SunFlowers Kosova dhe Step by Step Albania

### **Redaktor përgjegjës**

Remzije Krasniqi  
Hana Zylfiu- Haziri  
Mevlude Murtezi  
Majlinda Xhamo  
Bajram Shala

### **Kontribuesit e praktikave të mira:**

Edukatoret e institucioneve parshkollore nga Kosova dhe Shqipëria

**Lektorimi:** Besa Halimi- Zagragja

**Dizajni dhe shtypi:** Envinion

### **Falenderim për kontribut të veçantë në vlerësimin e praktikave të mira**

Prof. Ass.Dr. Majlinda Gjellaj  
Prof. Ass. Dr. Arlinda Beka  
Mevlude Aliu, Instituti Pedagogjik i Kosovës  
Bleta Balaj,  
Zana Zeqiri



## PERMBAJTA

Parathënie.....	4
Falenderime .....	5
Kompetenca 1.....	7
Kompetenca 2.....	21
Kompetenca 3.....	53
Kompetenca 4.....	68
Kompetenca 5.....	85
Kompetenca 6.....	113

## Parathënie

Ky doracak me praktika të mira të edukimit parashkollor është rezultat i punës së edukatoreve nga institucionet parashkollore në Kosovë dhe Shqipëri.

Realizimi i këtij botimi është përkrahur nga ISSA- International Step by Step Association përmes iniciativës ndër-rajonale “Aktivitete të të nxënimit mes kolegëve”, përmes Qendrës Sociale-Edukative SOS Kopshti, Prishtinë, Qendrës për Arsim të Kosovës- KEC, Balkan SunFlowers Kosova si dhe Hap pas hapi Albania.

Përmes këtij bashkëpunimi 10 institucione parashkollore nga Kosova dhe 4 nga Shqipëria kanë qenë pjesë e aktiviteteve që kanë pasur për qëllim mbledhjen e praktikave të mira që rezultojnë nga projektet për kompetencat e edukatoreve si dhe dokumentimin e tyre në doracak.

Doracaku ofron praktika dhe përvoja të mira nga edukatorët të cilat janë bazuar në kompetencat e edukatoreve në ***Instrumentin për Vlerësimin e Praktikave Cilësore në Shërbimet e Fëmijërisë së Hershme për Fëmijët 3 deri 6 vjeç.***

Praktikat e mira dhe shembujt e ofruar përmes këtij doracaku janë shkruar me përkushtim dhe përgjegjësi nga edukatorët dhe për këtë arsye kemi ruajtur origjinalitetin e praktikave të marra sipas rrëfimit të edukatoreve/mësueseve dhe nuk është ndërhyrë në mënyrën e interpretimit.

Duke pasur parasysh se mësimdhënia është art dhe arti ka mundësi të pakufishme të shprehjes, shkëmbimi i këtyre praktikave do të pasurojë imagjinatën dhe do të nxis kreativitetin e edukatoreve për ofrimin e aktiviteteve më cilësore për fëmijët tanë.



## Falenderime

Doracaku u hartua duke ju falenderuar kontributit dhe punës së drejtueseve dhe edukatoreve të institucioneve parashkollore.

### ***Institucionet parashkollore dhe edukatoret nga Kosova:***

**Institucioni parashkollor “PËLLUMBAT E PAQËS”, Pejë**

Edukatoret: Ardita Loxha, Shpresa Luta

**Institucioni parashkollor “GËZIMI YNË”, Mitrovicë**

Edukatoret: Mihrije Lahi, Naile Uka, Jehona Cana, Albiona Shabani

**Institucioni parashkollor “ENGJUJT”, Pejë**

Edukatoret: Arlindë Murtezaj dhe Albulena Jupa

**Institucioni parashkollor “NËNA KABRINI”, Prizren**

Edukatoret: Dila Kolaj, Ermira Mustafa, Leonora Dani, Albina Mihilli, Valentina Dushi, M. Violeta Vuçaj, Blerta Noci, Lindita Spaqi

**Institucioni parashkollor “YLLKAT”. Prishtinë**

Edukatoret: Rajmonda Ramadani

**Institucioni parashkollor “ARDHMËNIA”**

Edukatoret: Imrane Korça, Fidane Fana

**Institucioni parashkollor “GËZIMI YNË”, Prishtinë**

Edukatoret: Fatime Demolli Mustafa, Melihate Spahija Limani

**Institucioni parashkollor “SOS KOPSHTI”, Prishtinë**

Edukatoret: Kadrije Kadriu, Filoreta Popova, Shkëndije Maxhuni, Aida Ismajli, Ardiana Axhanela, Laura Gjistikaj, Afërdita Kavaja, Laureta Hasanaj,

**Institucioni parashkollor “BARDHA”, Prishtinë**

Edukatoret: Bukuriye Feka, Gentiana Çollaku, Zerina Kuçi, Shqipe Rashica, Lirije Dobruna, Afërdita Gashi, Saranda Haskaj

**Institucioni parashkollor “FATOSAT”, Prishtinë**

Edukatoret: Antigona Gillareva

### ***Kopshtet dhe edukatoret nga Shqipëria:***

- **Kopshti "Donika Kastrioti", Berat**  
Edukatoret: Elida Kumati
- **Kopshti "28 Nëntori", Berat**  
Edukatoret: Majlinda Dymishi, Ediola Daja
- **Kopshti "10 Korriku", Berat**  
Edukatoret: Shqiponja Ferro
- **Kopshti " Bep Tusha"**  
Edukatoret: Vjollca Krymi, Noeni Nikolli

# Kompetenca 1-3





# 1

## KOMPETENCA

## NDËRVEPRIMET

### Parimi

1.1. Edukatori/ Mësuesi ndërvepron me fëmijët në mënyrë miqësore dhe të respektueshme, duke mbështetur zhvillimin dhe ndërtimin e identitetit dhe dijeve të secilit prej tyre.

### Treguesi/t

1.1.4. Ndërveprimet e mësuesit u përgjigjen nevojave emocionale, fizike, psikologjike të çdo fëmije si edhe pikave të tyre të forta kognitive.

### Aktivitetet/ veprimtaritë edukative

Kopshti një hap i ri për mua

### Rezultatet e të nxënit

Shfaqin emocionet e ndryshme në raport me të tjerët

Marrin pjesë në lojëra dhe aktivitete

Ndërveprojnë me të rriturit dhe bashkëmoshatarët

Prindërit përfshihen në vendime që kanë të bëjnë me zhvillimin e fëmijëve

### Materiali i nevojshëm

Lodra të ndryshme, kukulla, shtëpi, enë të kuzhinës, paisje të kuzhinës, libra me ilustrime, fotografi familjare, rekuizita sportive, mjete pune e të tjera.

### Ndërlidhja e kompetencave

Strategjitë e mësimdhënies, familja dhe komuniteti, planifikimi dhe vlerësimi



## Faza I: Parapërgatitja

Aktivitetet e ndërmarra me qëllim të përshtatjes më të lehtë dhe më të shpejtë të fëmijëve në kopsht kanë filluar gjatë planifikimeve dhe përgatitjeve të edukatoreve për të pritur fëmijët e rinj në kopsht.

Në këtë rast edukatorët kanë grumbulluar informata nga prindërit për fëmijët e tyre që në ditën e parë të ardhjes së fëmijës në kopsht përmes një fletënjohjeje se çka duhet të dijë edukatorja për fëmijën në mënyrë që të njihen disa nga karakteristikat e fëmijëve.

Të dhënat e marra nga kjo fletënjohje tregojnë se prindërit njohin shumë karakteristika të fëmijëve dhe janë të gatshëm t'i ndajnë ato me edukatorët.

Marrja e disa të dhënave për fëmijën individualisht nga prindërit ka ndihmuar shumë në përpilimin e planit të aktiviteteve duke u bazuar në interesat dhe dëshirat e fëmijëve sa i përket zhvillimit të aktiviteteve kreative dhe lojërave sociale.

Po ashtu gjatë kësaj kohe fëmijët janë vëzhguar nga edukatorët se cilat lodra, rekuizita apo materiale i përdorin më shumë dhe cilat janë duke ndikuar në qetësimin dhe përshtatjen e tyre me kopshtin.

Pas marrjes së informacioneve të para nga prindërit nga fletënjohja është realizuar një pyetësor i shkurtër me prindër për të marrë më shumë informacione rreth kësaj çështje.

## Faza II: Realizimi

Në javën e parë janë realizuar aktivitete kreative, modelimi me plastelin, ngjyrosje, lojëra logjike me sajuese dhe blloqe si dhe lojëra sociale në grup të fëmijëve me qëllim socializimi ndërmjet fëmijëve dhe lidhjen e tyre me grupin. Po ashtu fëmijët kanë hulumtuar këndet edukative në dhomë duke përdorur lodrat logjike të cilat kanë arritur t'i ndajnë me fëmijët tjerë, edhe pse fëmijët në moshë shpesh nuk arrijnë të ndajnë lodrat me të tjerët pasi që është prezente ndjenja egocentrike gjatë lojës, që do të thotë secili dëshiron të luajë dhe ta ketë lodrën e tij të pëlqyer. Gjatë vëzhgimit të fëmijëve është vërejtur se angazhimi i tyre në lojëra sociale dhe kreative ndikon në qetësimin dhe përshtatjen e lehtë me kopshtin. Gjatë zhvillimit të lojërave fëmijët janë përqëndruar më gjatë në lojë, kanë përjetuar kënaqësi duke krijuar kështu miqësi dhe afërsi me njëri tjetrin.

Mirëpo, jo të gjithë fëmijët i kanë pranuar lehtë këto lojëra dhe aktivitete kreative. Disa prej tyre kanë qëndruar jashtë grupit duke vëzhguar lojën apo duke luajtur individualisht.



Aktivitete psikomotorike, kërcim me litarë kërcim në trampolinë, lojëra lëvizëse, zvarritja, si dhe rrëshqitja në topogan.

Planifikimi i aktiviteteve tjera në ditët në vazhdim janë fokusuar në aktivitetet psikomotorike, si: muzikë, vallëzim dhe dramatizim me kukulla, lojëra simbolike si: roli i nënës dhe bebes, treni nisët në kopsht për të marr fëmijët dhe lojërat psikomotorike gjatë të cilave ata janë argëtuar shumë, është qetësuar pothuajse çdonjëri prej tyre dhe janë lidhur më shumë emocionalisht me njëri tjetrin.



Lojërat simbolike si, dramatizimi me kukulla, “Treni nisët në kopsht për të marrë fëmijët”.

Aktivitete psikomotorike, kërcim me litarë kërcim në trampolinë, lojëra lëvizëse, zvarritja, si dhe rrëshqitja në topogan.

Po ashtu aktivitetet kreative dhe disa lojëra shoqërore janë praktikuar edhe jashtë dhomës së fëmijëve me qëllim që të përforcohet përshtatja e fëmijës me gjithë ambientin që do ta rrethojë në kopsht.

Këto aktivitete janë zhvilluar në oborr të kopshtit përmes lodrave dhe rekuizitave sportive të cilat ndikuan jashtëzakonisht shumë në qetësimin e fëmijëve. Të gjithë fëmijët janë ndier të relaksuar, pa ndonjë pengesë, kanë luajtur jashtë me njëri tjetrin, kanë hulumtuar vendin dhe kanë organizuar lojëra të lira.



Lojëra shoqërore në natyrë me rekuizita sportive



### Faza III: Reflektimi

Shumë nga aktivitetet dhe lojërat të cilat prindërit i kanë cekur, janë realizuar në kopsht dhe fëmijët i kanë pranuar shumë mirë si dhe janë ndier të relaksuar.

Aktivitetet e kësaj jave kanë zgjuar shumë interesim tek fëmijët, e sidomos përdorimi i rekuizitave psikomotorike, kërcimi në pajisje dhe vallëzimi me muzikë. Gjatë kësaj kohe fëmijët kanë qenë shumë të relaksuar, nuk kanë qajtur, janë përfshirë në të gjitha lojërat duke mos hezitur asnjëherë. Zhvillimi i këtyre lojërave ka ndikuar që fëmijët për këtë kohë të harrojnë se janë larg prindërve apo të qajnë për mungesën e tyre.

Po ashtu bazuar në përgjigjet e prindërve dhe vëzhgimet e edukatorëve gjatë kësaj periudhe prej 4 javësh, fëmijët e grupit 3-4 vjeç janë duke u përshtatur shumë mirë me kopshtin, shumica e fëmijëve vijnë me dëshirë në kopsht, nuk shfaqin sjellje protestuese në mëngjes kur ndahen nga prindërit, përfshihen në aktivitete edukative dhe kanë përqëndrimin e duhur.

Për dallim nga vitet e kaluara, kohëzgjatja e përshtatjes së fëmijës me kopshtin këtë vit ishte më e shpejtë dhe më e lehtë duke pasë në konsideratë parapërgatitjen e fëmijëve nga prindërit para se ata të fillojnë kopshtin, si dhe përgatitjen e duhur të edukatoreve për grupmoshën e caktuar të fëmijëve dhe përshtatjen e aktiviteteve edukative që përkrahin fëmijët në mënyrë që këtë fazë ta kalojnë sa më mirë.

# 2

## KOMPETENCA

## NDËRVEPRIMET

### Parimi

1.1. Edukatori/ Mësuesi ndërvepron me fëmijët në mënyrë miqësore dhe të respektueshme, duke mbështetur zhvillimin dhe ndërtimin e identitetit dhe dijeve të secilit prej tyre.

### Treguesi/t

1.1.6. Ndërveprimet e mësuesit me fëmijët zhvillojnë nismën, pavarësinë, vetë-mjaftueshmërinë dhe lidhshërinë e tyre.

### Aktivitetet/ veprimtaritë edukative

Udhëtojmë me mjete të ndryshme të komunikacionit

### Rezultatet e të nxënit

Dallojnë llojet e komunikacionit, zhvillojnë imagjinatën krijuese, diskutojnë dhe argëtohen gjatë aktiviteteve, lojës dhe vizitave, ndërveprojnë me të rriturit dhe bashkëmoshatarët.

### Materiali i nevojshëm

Libra me ilustrime të llojeve të komunikacionit, fotografi të mjeteve udhëtuese, lodra të kopshtit (rrolera, trotineta, bicikleta, motora, vetura, kamiona, tren me binarë, aeroplan, helikopter, anije, barka etj.) materiale recikluese, materiale e mjete nga: druri, shpuza, stiropor, letër karton, ngjitës, gërshërë, letra vezulluese, ngjyra të ndryshme, etj.

### Ndërlidhja e kompetencave

Strategjitë e mësimdhënies, familja dhe komuniteti, mjedisi mësimor, planifikimi dhe vlerësimi



## Faza I: Parapërgatitja

Fillimisht, projekti është planifikuar në bazë të përgatitjeve të mëhershme të edukatoreve duke u nisur nga njohuritë paraprake që kanë fëmijët për mjetet dhe mënyrën e udhëtimit. Pjesë e planifikimit ishin edhe prindërit të cilët ndihmuan në preferencat e fëmijëve për mjetet e udhëtimit dhe realizimin vizitave. Për secilin fëmijë u përgatitën libërthat e formatit A/4 ku u përcaktuan shumë faqe për vizatim dhe ngjitje të fotove për llojet e ndryshme të mjeteve të komunikacionit.

Projekti i titulluar “Udhëtojmë me mjete të ndryshme të komunikacionit” është menduar që të zgjasë për disa javë, me mundësi të vizitave në përmbyllje të secilës javë. Secila vizitë përmbëllë një llojë të komunikacionit, psh: javën e parë- vizitë në Qendrën Rekreative “Gorenje”; javën e dytë – vizitë në Kompaninë e shitjes së veturave “ Auto Mita”; javën e tretë – vizitë nëaeropotin “Adem Jashari”; javën e katërt – vizitë në liqenin e Badovcit me aktivitetin ”Lundrojmë së bashku me barka”.

Në fund të fazës përgatitore prindërit plotësuan fletëkonfirmimet për vizita jashtë kopshtit, si dhe sigurohet transporti dhe të gjitha materialet e nevojshme për realizimin e projektit.

## Realizimi

### Komunikacioni, mjetet dhe rregullat e udhëtimit

Gjatë takimit të mëngjesit është bashkëbiseduar me fëmijë rreth mënyrës së udhëtimit nga shtëpitë e tyre deri në kopsht. Fëmijët janë njoftuar në përgjithësi me të gjitha llojet e komunikacionit dhe mjetet e ndryshme të udhëtimit përmes figurave, ilustrimeve dhe lodrave. Me materialet e mbledhura janë punuar së bashku disa prej mjeteve të preferuara të udhëtimit dhe janë vendosur në oborrin e kopshtit, të cilat fëmijët i kanë përdorur në aktivitetet ditore të planifikuara. Fëmijët kanë përzgjedhur mjetet e preferuara për të improvizuar lojëra të ndryshme.

Në përmbyllje të javës u vizitua qendra rekreative “Gorenje” si pjesë e temës “Udhëtojmë me mjete të ndryshme të komunikacionit”. Në këtë vizitë fëmijët arritën të bëjnë gara me vetura (lodra) në një hapësirë të përshtatshme për ta. Aktivitetet vazhduan me temën për komunikacionin rrugor, diskutimit rreth rregullave, mënyrave të udhëtimit dhe mjeteve të shumëllojshme rrugore. Fëmijët bëjnë grumbullimin e fotove, vizatimeve për albumin individual dhe së bashku me edukatore improvizojnë me materiale të ndryshme një maket me mjete të ndryshme të udhëtimit të komunikacionit rrugor. Në përmbyllje të javës u vizitua kompania e shitjes së veturave “ Auto Mita” e cila vizitë



fëmijëve ju mundësoi të shohin për së afërmi llojet e ndryshme të veturave, të flasnin dhe diskutojnë me të tjerët për dëshirat rreth modeleve të veturave.

Tema për komunikacionin ajror ishte e radhës ku u bashkëbisedua për rregullat, mjetet dhe për mënyrën e udhëtimit. Fëmijët bëjnë vizatime grumbullojnë foto për albumin individual dhe punojnë me argjilë e materiale të ndryshme ricikluese një maket me mjete të ndryshme të komunikacionit ajror. Në përmbyllje të javës është vizituar aeroporti ndërkombëtarë “Adem Jashari” ku fëmijët u njoftuan me procedurat e udhëtimit me aeroplan duke parë pistën e aeroplanëve dhe duke parë për së afërmi një aeroplan në aterim.

Java fillon duke ju referuar komunikacionit ujor, rregullave, mjeteve dhe mënyrës së udhëtimit. Fëmijët bëjnë vizatime, grumbullojnë foto për albumin individual dhe në klasë bëhet improvizimi i lojës me varka duke filluar me rregullimin e ambientit, improvizimin e liqenit me pëlhurë të kaltërt, në të cilin vendosen varkat e punuara nga kartoni ditë me parë. Fëmijët vendosen prapa varkës dhe imagjinojnë një ditë lundrimi përmes lojës së lartëpërmendur.

Në përmbyllje të javës i bëhet vizitë liqenit të Badovcit ku zhvillohet aktiviteti “Lundrojmë së bashku me barka” ku fëmijët shijojnë lundrimin për së afërmi duke kaluar nga njëra anë e liqenit në anën tjetër me barka të vogla së bashku me edukatoredhe me prindër.

### Këndëvështrimi i fëmijës/ prindit:

Fëmijët e shijuan të nxënit përmes lojës, me shumë emocione në aktivitetet e ndryshme të realizuara në kopsht dhe vizita. Prindërit ishin mbështetës dhe përkrahës aktiv në realizimin e projektit.

Përgjatë katër javëve janë realizuar aktivitete kreative, modelimi me plastelinë e argjilë, vizatim, ngjyrosje, lojëra logjike me sajuese dhe blloqe si dhe lojëra sociale në grup të fëmijëve me qëllim të socializimit të fëmijëve gjatë punës në grup.

Planifikimi i aktiviteteve tjera ka qenë i fokusuar në aktivitetet psikomotorike, muzikë, vallëzim, aktrime dhe improvizime, lojëra të ndryshme që kanë argëtuar dhe kanë sjellë shumë emocion tek fëmijët. Këto aktivitete janë zhvilluar në dhoma, në oborrin e kopshtit përmes lodrave dhe rekuizitave sportive të cilat ndikuan jashtëzakonisht shumë në përmbylljen e fëmijëve.



## Reflektimi

Në këtë projekt morën pjesë pothuajse të gjithë fëmijët. Ata i kanë pranuar shumë mirë dhe janë ndër të relaksuar gjatë lojërave dhe aktiviteteve. Për ta ishte tërheqëse puna dhe angazhimi në secilin aktivitet duke bërë pyetje të vazhdueshme rreth mjeteve të udhëtimit. Aktivitetet më mbresëlënëse ishin vizitat e realizuara përgjatë muajit dhe libri i krijuar për komunikacionin.

Fëmijët arritën të përshkruajnë secilin aktivitet qartë te prindërit e tyre dhe reflektuan tek ata respektimin e rregullave të komunikacionit dhe mënyrat e ndryshme të udhëtimit, librin individual të secilit fëmijë “Udhëtojmë me mjete të ndryshme të komunikacionit”. Aktivitete të ngjashme mund të organizohen edhe me vizitë në hekurudhë apo fabrika të ndërtimit të mjeteve të ndryshme udhëtuese.



# 3

## KOMPETENCA

## NDËRVEPRIMET

Parimi

1.1. Edukatori/ Mësuesi ndërvepron me fëmijët në mënyrë miqësore dhe me respekt, duke mbështetur zhvillimin dhe ndërtimin e identitetit dhe dijeve të secilit prej tyre.

Treguesi/t

1.1.3. Edukatori/ Mësuesi ndërvepron gjatë gjithë ditës me secilin fëmijë, duke ndërtuar pikat e tyre të forta dhe duke nxitur nxënien dhe zhvillimin e tyre.

Aktivitetet/veprimtaritë edukative

Trupi im

Rezultatet e të nxënit

Zgjerimi i informacionet tek fëmijët për ndërtimin e trupit dhe rolin e shqisave, të të shprehurit në mënyrë të kuptueshme dhe të qartë, aftësitë për të komunikuar dhe bashkëvepruar me njëri tjetrin gjatë aktiviteteve dhe lojës.

Materiali i nevojshëm

Libra me ilustrime, figura me trupin e njeriut, fleta të bardha, ngjites, materiale me aroma dhe shije të ndryshme, si: limon, sheqer, krip, parfum, etj.

Ndërlidhja e kompetencave

Përfshirja, diversiteti dhe vlerat e demokracisë, mjedisi mesimor



## Parapërgatitja

Tema “Trupi im” është përzgjedhur me qëllim të zgjimit të njohurive të fëmijeve lidhur me ndërtimin e trupit të njeriut, gjymtyrëve dhe funksionit të tyre, si dhe njohja dhe zgjërimi i informacionit për pesë shqisat. Tema e përzgjedhur do të trajtohet për dy javë. Në ditën e parë u diskutua dhe u zhvilluan aktivitete lidhur me ndërtimin e trupit të njeriut, ndërsa aktivitetet e ditës së dytë fokusohen në njohuritë e zgjeruara për pesë shqisat. Gjatë fazës përgatitore, janë përgatitur figura me fotografi të trupit të njeriut, duke paraqitur organet dhe gjymtyrët të cilat do të përdoren gjatë zhvillimit të aktiviteteve.

## Realizimi

Gjatë rutinës ditore/kohës së rrethit dhe njohjes me kalendarin, edukatorët fillojnë të parashtrajnë pyetje për fëmijët, duke prezantuar kështu temën javore. P.sh. fëmija që është duke prezantuar kalendarin, pyetet se çfarë po bënë me këmbë/duar? Pyetjet u parashtrohen edhe fëmijëve të tjerë, duke i inkurajuar që të mendojnë për sa më shumë funksione që kryejnë me këmbë, psh. kërcel, vrapoj, eci, etj.

Pasi që u është dhënë mundësia të gjithë fëmijëve të marrin pjesë në diskutim, prezantohet një fotografi me pjesët e trupit të njeriut. Fëmijët vazhdojnë diskutimin duke emëruar pjesët e trupit të prezantuara në fotografi dhe ndajnë njohuritë e tyre lidhur me funksionin e organeve dhe pjesëve të prezantuara të trupit.

Diskutimi drejtohet rreth dallimit ndërmjet pjesëve të jashtme të trupit dhe organeve të brendshme të trupit, duke inkurajuar secilin fëmijë, pa dallim, të jetë pjesë e diskutimit në mënyrën që i përshatet.

Gradualisht, fillon të zhvendoset përqendrimi nga fotografia në trupin tonë, duke iu kërkuar fëmijëve që të vendosin dorën në anën e majtë të gjoksit. Pasi të gjithë të kenë kuptuar udhëzimin dhe të kenë vendosur dorën e tyre mbi zemër, i pyesim se çfarë po ndiejnë/dëgjojnë (të rrahurat e zemrës). Pastaj vazhdojmë me udhëzime tjera p.sh. Fëmijëve u kërkojmë të marrin frymë thellë dhe të vërejnë se si u zgjerohet gjoksi, dhe pastaj të lirojnë frymën duke vërejtur të kundërtën (kur mushkëritë mbushen me ajër dhe zbrazen).

**Fëmijëve u prezantohet edhe një ilustrim me skeletin e njeriut dhe analizohet së bashku. Ngrihemi në këmbë këndojmë këngën:**

Ngrije dorën lart,  
lëshoje dorën poshtë,  
preke krahun ti,  
preki veshët pak.  
Preki gjunjët pak,  
dhe këpucët tash,  
preke barkun ti,  
tani pusho pak.

Gjatë zhvillimit të aktivitetit edukatorët shprehin vlerësim për pjesëmarrjen e secilit fëmijë dhe me kujdes plotësojnë njohuritë ekzistuese të fëmijëve lidhur me temën.

Aktiviteti vazhdohet në qendrat e punës ku fëmijët përdorin materiale të ndryshme. Në qendrën e artit fëmijët punojnë në fletë pune me vija të ndërprera të cilat i përdorin për të formuar trupin e një vajze dhe një djali. Grupi tjetër modelon trupin e njeriut me petëza gjeometrike, grupi në qendrën e blloqeve demonstroi fuqinë, prekjën, peshën, pozicionin e trupit që merr gjatë kryerjes së një pune/loje. Aktivitetet vazhdojnë me përcjelljen e një dokumentari për trupin dhe shqisat si loja simbolike ku një fëmijë mbyll dhe zbulon se kush e prek apo i pëshpërit në vesh.

Dita përmbyllet me aktivitetet fizike lëvizore duke luajtur lojën e preferuar “kërcejmë nëpër gjurmët e këmbëve”. Aktivitetet në ditën tjetër fillojnë me një reflektim të shkurtër të temës për trupin, duke rikujtuar aktivitetet e zhvilluara një ditë më parë dhe njohuritë e reja, me anë të fotografive të shqisave dhe fillohet me prezantimin e temës për shqisat.

Shqisat prezantohen përgjatë javës, duke zgjedhur që secilën ditë të prezantohet një shqisë e re.

**Shqisa e të prekurit:** gjatë takimit të mëngjesit fëmijët pyeten se me çfarë prekim (me duar). Për të demonstruar i vendosim disa gjëra të forta dhe lodra të buta në mes dhe fëmijët fillojnë të prekin gjesendet e prezentuara dhe përshkruajnë ndjeshmërinë (e fortë, e butë). Ushtrimin e praktikojmë edhe duke prekur gjësendet me sy mbyllur dhe fëmijët bëjnë dallimin e ndjeshmërisë vetëm përmes shqisës së të prekurit.



**Shqisat e të pamurit:** aktivitetet fillojnë me lojën symbyllazi, ku së pari edukatorja demonstroi dhe paraqet vështirësitë e orientimit në klasë me sy të mbyllur dhe loja vazhdon me fëmijët tjerë. Pas lojës zhvillohen pyetjet dhe diskutimi rreth asaj se si orientohemi në klasë, ku hasëm në vështirësi, si u ndjemë, etj. Diskutimi vazhdohet rreth rëndësisë së shqisës së të parit për t'u orientuar dhe me anë të pyetjeve zgjohet interesimin i fëmijëve për të menduar se çfarë mund të bëjmë nëse shqisa e të parit është e dëmtuar dhe për çfarë na nevojiten syzet apo llupa të cilat demonstrohen.

**Shqisa e të dëgjuarit:** fëmijëve u prezantohen tinguj të ndryshëm, psh. përmes ziles, muzikës, trokitjes me intensitete të ndryshme të tingujve dhe pyeten fëmijët se me çfarë po dëgjojnë. I mbyllim veshët dhe u kërkojmë fëmijëve të shprehin dallimin që kanë ndjerë me veshë të hapur dhe të mbyllur. Diskutimi drejtohet rreth rëndësisë së shqisës së të dëgjuarit dhe funksionit që ajo ka në jetën e njeriut. Njëherit fëmijët nxiten të mendojnë çfarë ndodhë nëse shqisa e të dëgjuarit dëmtohet dhe diskutimi vazhdon me demonstrimin e aparatit të dëgjimit.

**Shqisa e të nuhaturit dhe të shijuarit:** fëmijëve u ofrohen disa materiale dhe produkte ushqimore me aroma dhe shije të ndryshme për të dalluar. Fëmijëve u ofrohet mundësia të shijojnë disa ushqime më shije dhe aroma të ndryshme. Ky ushtrim u ndihmon fëmijëve të reflektojnë se si shqisa e të shijuarit dhe të nuhaturit ndihmon në dallimin e shijeve, aromave dhe preferencave si dhe funksionin që ato kanë në jetën e njeriut. Edukatorët kujdesen që të gjithë fëmijët të përfshihen në aktivitete dhe gjatë diskutimeve mbështesin fëmijët që të paraqesin qartë mendimet e tyre.

## Reflektimi

Përmes aktiviteteve të zhvilluara fëmijët zgjeruan njohuritë e tyre lidhur me ndërtimin e trupit dhe funksionimin e organeve, si dhe për llojet dhe rolin e shqisave në jetën e njeriut. Gjatë aktiviteteve doli si ide për të vizituar mjekun i cili do të na informojë më shumë për organet e trupit dhe funksionin e tyre dhe kjo do të realizohet në bashkëpunim me prindërit.



# Kompetenca 2-5





# 1

## KOMPETENCA

## FAMILJA DHE KOMUNITETI

### Parimi

2.3.Eduaktori/Mësuesi përdor burimet e komunitetit dhe kulturën e familjeve për të pasuruar zhvillimin dhe përvojën e të nxënësve të fëmijëve

### Treguesit

Eduktori/Mësuesi përdor njohuritë e komuniteteve të fëmijëve dhe të familjeve si pjesë integrale të programit mësimor dhe të përvojave të tyre mësimore

### Emri i aktivitetit

T'i duam gjyshërit tanë

### Rezultatet e të nxënësve

Dinë për histori të ndryshme për jetën e të moshuarve  
Kuptojnë ku dhe si jetojnë të moshuarit  
Përkujdesen me dhuratat për të moshuarit

### Materiali i nevojshëm

Dhurata, syze, lodra të ndryshme etj.

### Ndërlidhja e kompetencave

Gjithpërfshirja dhe diversiteti, ndërveprimi



## Parapërgatitjet:

Në fillim të vitit të ri të punës në kopsht është planifikuar plani global për vitin e ardhshëm, pastaj jemi takuar me prindërit e grupit, ku i kemi informuar për planin dhe çka do të mësojnë fëmijët në kopsht. Prindërit janë njoftuar me tematikat e planifikuara, veprimtaritë që do të zhvillohen nëpër qendrat e aktivitetit, metodologjinë dhe teknikat që do ta përdorim me fëmijët.

Familjet e fëmijëve janë një burim i pashtershëm ndihme të cilin në kopshtin tonë e përdorim, jo vetëm për të lehtësuar punën tonë si edukatore, por edhe për të rritur bashkëpunimin midis kopshtit dhe komunitetit.

Temën e muajit tetor “T’i duam gjyshërit tanë”, e kemi prezantuar para prindërve duke e ndërlidhur me Një tetorin, ditën ndërkombëtare të të moshuarve.

Kemi kërkuar që prindërit të na ndihmojnë me një dhuratë modeste për vizitën që do ta bëjmë në Shtëpinë e të moshuarve. Me këtë rast është paraparë që secilit të moshuar, fëmijët do t’i dhurojnë nga një dhuratë. Pas këtij aktiviteti fëmijët kanë treguar ditën kur do të vijnë gjyshërit e tyre në kopsht për të sjellë gatimet e tyre të cilat i kanë prezantuar para fëmijëve.





## Realizimi

Java fillon me bisedën me fëmijët, të ulur në rreth të cilëve duke u shtruar pyetje i kemi nxitur të tregojnë emrat e gjyshërve të tyre nga nëna, pastaj emrat edhe emrat e gjyshërve nga babai. Në grupin tonë kuptuam se ishte vetëm një vajzë që nuk kishte gjyshen nga ana e nënës, kurse të tjerët i kishin të dy gjyshërit. Pastaj me fëmijët kemi diskutuar për kujdesin dhe dashurinë që ofrojnë gjyshërit si dhe ngjarje nga jeta që atyre u kanë bërë përshtypje.

Pasi që të gjithë fëmijët kanë folë për lidhjen që kanë me gjyshërit, kemi lexuar edhe vjershën: “Gjyshërit e mi”

Kam një gjyshe  
 Dhe një gjysh ,  
 Në park me ta ,  
 Dal e shetis.  
 Përralla gjyshi ,  
 Shpesh më tregon  
 Dhe gjyshja kokën  
 Ma ledhaton.  
 Sa shum i dua!  
 Sa xhan i kam!  
 I lumtur jam,  
 Qe i kam pranë.



Së bashku me fëmijët kemi komentuar vargjet e vjershës , duke i nxitur të shprehen me fjali sa më të sakta. Ata flasin për kujdesin dhe dashurinë që tregojnë gjyshërit për ta, duke treguar ngjarje të ndryshme që u kanë ndodhur me gjyshërit e tyre.

Më pas fëmijët kanë shkuar në qendra ku kanë luajtur dhe demonstruar role të ndryshme. P.sh. në **qendrën e familjes** kanë demonstruar role të gjyshërve të tyre. Disa nga fëmijët kanë vendosur syzet dhe kanë bërë gjëja se po thurin triko apo po gatujnë ushqimet e preferuara, derisa disa bënë sikur lexonin gazetën apo punonin kopshtin, etj. Në **qendrën e matematikës, me** rrathë të vizatuar paraprakisht në letra të mëdha, janë krijuar bashkësitë e gjysheve dhe gjyshërve, duke shënuar emrat e tyre me ndihmën e shokëve. Në **qendrën e blloqeve** është punuar kopshti i gjyshërve në fshat.

Pasdite u kemi kërkuar fëmijëve që të ftojnë gjyshërit që gjatë javës të vijnë në kopsht, po ashtu edhe prindërit janë ftuar që të jenë pjesë në këto takime.

Të nesërmen erdhi gjyshja e njërit fëmijë të grupit, të cilën e përshëndetëm të gjithë së bashku, gjyshja po ashtu i përshëndeti të gjithë me radhe dhe filloi me pyetje për secilin fëmijë. Pastaj gjyshja filloi tu tregonte fëmijëve për lojërat që ajo ka luajtur kur ka qenë fëmijë dhe për mënyrën e jetesës në kohën e saj. Ajo kishte sjellë një monedhë, pëlhurë dhe disa penj me të cilët fëmijëve ua punoi një kukull si ato të fëmijërisë së saj. Fëmijët ishin shumë kureshtar për të parë procesin e krijimit të kukullës. Në fund gjyshja mori disa ngjyra/fllomastera dhe e zbukuroi kukullën sipas sugjerimeve të fëmijëve. Pas kësaj gjyshja u tregoi edhe një përralle. Përralla ishte aq e bukur dhe emocionuese sa në fund disa fëmijët kishin nevojë ta përqafonin gjyshen. Në këtë moment edukatorja ndërhyri dhe foli për respektin ndaj të moshuarve dhe ndihmën që duhet t’u dhurojmë atyre.

Të nesërmen pas takimit të mëngjesit me fëmijët i morrëm dhuratat me vete dhe u nisëm për në shtëpinë e të moshuarve. Aty na priti drejtoresha e cila na dërgoi tek salla ku na pritën të moshuarit. Aty pamë edhe personelin që kujdesej për të moshuarit, kuzhinën ku përgatitej ushqimi i tyre, dhomat ku ata flenë, hapësirat për aktivitete të ndryshme etj.

Paraprakisht kur bëmë planet për vizitë kuptuam se një i moshuar kishte ditëlindjen pikërisht më 1 tetor, ditën kur ne po shkonim për vizitë. Për këtë rast kuzhina qendrore e kopshtit kishte përgatitur një ëmbëlsirë të cilën e dhuruam në vizitë duke kënduar këngën “Shumë urime për ty”. Pastaj fëmijët filluan të bisedojnë me të moshuarit, disa prej fëmijëve u afruan dhe biseduan individualisht me ta. Pas një kohe i dhuruam dhuratat e përgatitura, me ç’rast secili fëmijë pati mundësi që të dhuronte një dhuratë. Ishte një ditë shumë interesante. Kur u kthyem në kopsht kërkuam nga

fëmijët të punojnë një punim me përshtypjet nga “Shtëpia e pleqëve”. Punimet të cilat fëmijët i prezantuan ishin shumë interesante dhe domethënëse.



Gjatë javës patëm edhe dy gjyshe që erdhën në kopshtin tonë dhe kaluan kohë me fëmijët duke ju treguar histori nga jeta e tyre. Në fund të javës së bashku me fëmijët bëmë përgatitjet për pritjen e gjyshërve në kopsht, ku rregulluam së bashku klasën, tavolinat dhe dekoret.

Gjyshërit filluan të vijnë me radhë duke sjellë ushqime të përgatitua për fëmijët. Fëmijët i pritën dhe u uruan mirëseardhje. Prania e gjyshërve të tyre u solli shumë gëzim i cili dukej aq qartë në fytyrën

e secilit. Pastaj të gjithë u ulën së bashku për të shijuar ushqimin. Ndërkohë tre fëmijë ishin ulur në një kënd të klasës dhe qanin.

Arsyeja ishte se atyre nuk u kishin ardhur gjyshërit, ndërsa, dhe një tjetër qante se nuk kishte gjyshër. Ai thoshte se ata kanë shkuar në qiell. Një gjyshe që kuptoi shqetësimin e fëmijëve u tha atyre se sot ajo do të jetë gjyshja e tyre dhe i afroi afër vehtes. Më pas gjyshërit prezantuan ushqimet e tyre të cilat i shijuan së bashku. Në fund fëmijët shfaqën programin duke kënduar këngë dhe vjersha për gjyshërit.



## Reflektimi:

Pas takimit reflektues, ne edukatoret vendosëm që këtë temë ta përsërisim gjatë vitit duke realizuar ndonjë vizitë tek gjyshërit që do të na mundësonte të njihemi me ndonjë nga hobit apo profesionet e tyre. Kjo lindi si ide kur kuptuam se një gjysh i fëmijëve po merrej me kultivimin e bletëve, ndërsa një gjyshe kishte një kompani për ëmbëlsira.

### Vështirësitë /sfidat:

Gjatë realizimit të temës kemi pasur vështirësi në sigurimin e transportit të fëmijëve por në fund e kemi realizuar me sukses.

# 2

## KOMPETENCA

## FAMILJA DHE KOMUNITETI

### Parimi

2.1. Edukatori/ Mësuesi nxit partnership me familjet dhe ofron mundësi të larmishme familjeve dhe anëtarëve të komunitetit që të përfshihen në procesin e zhvillimit dhe të mësuarit të fëmijëve

### Treguesit

2.1.3. Edukatori/ Mësuesi përfshijnë anëtarët e familjes në vendim-marrje të përbashkëta në lidhje me procesin mësimor, zhvillimin dhe jetën në klasë të fëmijëve të tyre.

### Aktivitetet/veprimtaritë edukative

Familja ime

### Rezultatet e të nxënit

Takojnë dhe prezantojnë anëtarët e familjeve të ndryshme dhe krijojnë raporte miqësore

Prindërit angazhohen vullnetarisht dhe marrin pjesë aktive në veprimtari edukative në kopsht

Prindërit ndërveprojnë mes vete dhe kontribuojnë në mënyra të ndryshme për kopshtin

Prindërit përfshihen në vendime që kanë të bëjnë me zhvillimin e fëmijëve

### Materiali i nevojshëm

Lodra të ndryshme, kukulla, shtëpi, enë të kuzhinës, paisje të kuzhinës, libra me ilustrime, Cd të ndryshme mbi familjen, letër, ngjitës, ngjyra druri, mjete të cilat i sjellin prindërit sipas profesioneve të tyre, fotografi familjare, e të tjera.

### Ndërlidhja e kompetencave

Ndërveprimi dhe Strategjitë e mësimdhënies,



## Faza I: Parapërgatitja

Për përgatitjen e aktiviteteve ku përfshihen prindërit si dhe antarët e familjes dhe komunitetit, sigurisht që kërkohet përkushtim dhe kujdes i veçantë.

Fillimisht ekipi i edukatoreve përpiloi listën e vizitave të mundshme dhe të ftuarve që do të marrin pjesë gjatë ditëve në vazhdim duke pasur parasysh informatat që kanë marrë nga prindërit në takimet e mëparme rreth profesioneve të tyre, prirjeve dhe interesimit të tyre për të mbështetur aktivitetet e kopshtit.

Prindërit u kontaktuan dhe me të gjithë caktuam kohën kur do të marrin pjesë në aktivitete, u dakorduam për sigurimin e materialeve dhe mjeteve të nevojshme për të zhvilluar aktivitetet, përcaktuam formën e punës se si planifikojmë të realizojnë vizitën e të tjera. Letra informative rreth vizitave të të ftuarve në kopsht u vendos në hyrje të dhomës së fëmijëve me qëllim të informimit të të gjithë prindërve.

Megjithatë një ndër aktivitetet që mori më shumë kohë për përgatitje ishte vizita- shëtitja në Rugovë. Ishte e nevojshme të bëheshin përgatitje në lidhje me udhëtimin, ushqimin, si dhe materialet tjera që nevojiteshin për shetije.

Të gjitha u realizuan në bahskëpunim dhe komunikim me prindër e sidomos çështja e transportit për në Rugovë që u siguroa në tërësi nga prindërit dhe në këtë mënyrë u mundësua që në këtë aktivitet të jenë pjesëmarrës sa më shumë prindër që do të ishin afër fëmijëve të tyre, dhe që do të ndihmonin rreth sigurisë së fëmijëve në një ambient jashtë kopshtit. Qëllimi i kësaj vizite ishte që fëmijët të kenë mundësinë të jenë bashkë në të njëjtin ambient, të njoftohen me natyrën jashtë qytetit, gjelbërimin, lulet, pastaj duke shijuar natyrën të relaksohen dhe argëtohen në ajër të pastër, të ushqehen në natyrë por edhe të përfitojnë njohuri dhe shkathtësi të reja.



## Faza II: Realizimi

Planifikimi i një shetitje në natyrë jashtë objektit të kopshtit nxit tek fëmijët kureshtjen, përkushtimin, gëzimin, entuziazmin, jep mundësi për hulumtim, nxit komunikimin mes fëmijëve, aktivizon të gjithë për të kontribuar që dita të jetë aktive dhe interesante.

Gjatë parapërgatitjes, jemi munduar të jemi të kujdesshëm për çdo detaj, në mënyrë që ajo çfarë kemi planifikuar, të realizohet në mënyrën më të mirë të mundshme dhe fëmijët të arrijnë të arrijnë por edhe të mësojnë gjëra të reja. Meqenëse ishte hera e parë që organizonim një shetitje me këtë grup të fëmijëve, edukatorët vendosën që para se të nisën të takohen me të gjithë fëmijët në dhomë me qëllim që të informohen të gjithë për kohën e nisjes, kohëzgjatjen e rrugës deri në Rugovë, ndarjen e roleve dhe përgjegjësisë për secilin, që të vetëdijesohen për kujdesin që duhet të kenë për njëri-tjetrin dhe informata tjera të cilat u ndanë në një takim të shkurtër.

U dakorduar që nisja të jetë në orën 09:00 dhe në këtë kohë të gjithë ishim gati për në Rugovë. Gjatë udhëtimit në autobus fëmijët këndonin këngë të ndryshme dhe entuziazmi rritej sa ofroheshim tk vendi. Pasi arritëm në Rogovë i sistemuam të gjitha gjërat e nevojshme që kishim marrë me vete, bëmë një takim të përbashkët në rreth, ku prezantuam aktivitetet e ditës. Fëmijët dhe prindërit u prezantuan dhe pastaj diskutuam për gjërat e përbashkëta që kemi për t'i bërë. Po ashtu duke marrë propozimet e të gjithëve u dakorduar edhe për rregullat e shetitjes. U vendos që të kujdesemi për për njëri – tjetrin dhe ambientin, të ndihmojmë njëri-tjetrin kur kemi nevojë dhe të sillemi mirë me të gjithë.

Meqenëse grupi ishte i madh filluam lojëra të ndryshme në grupe të vogla duke ndryshuar grupet me qëllim që të ju mundësonim të gjithëve të njiheshin dhe të bashkëbisedonin me njëri-tjetrin.

Përveç lojërave, gjatë ditës u zhvillua ecja dhe vëzhgimi në natyrë, duke diskutuar dhe zhvilluar lojën e memories. Pra ishte me rëndësi se cilat gjëra i vërejtëm më parë, të mbanim mend shifrat nga numërimi gjethëve, luleve, e të tjera që sollën shumë ngazëllim dhe buzëqeshje tek fëmijët.

Pas një pushimi freskues me ushqime të ndryshme të sjella kryesisht nga prindërit, filluan lojërat lëvizëse dhe vrapimet në natyrë që aktivizuan çdo fëmijë, çdo prind dhe edukatore për të marrë pjesë dhe për të brohoritur për shkathtësitë e larta që fëmijët tregonin gjatë aktiviteteve, si vrapimet e shpejta, etj. Në fund të shetitjes të gjithë në rreth shprehëm përshtypjet e ditës dhe ndamë me njëri tjetrin gjërat që i pëlqyem më së shumti duke i dhënë mundësi secilit të flasë dhe të tregojë për ngjarjet dhe emocionet që përjetuan.



Momente nga shetitja në natyrë



Java tjetër e bashkëpunimit me familjen vazhdoi me shumë vizita të tjera që na u bënë nga mysafirë të ndryshëm, si prindër, gjyshër dhe pjesëtarë tjerë të familjeve të fëmijëve.



Bashkëbisedimi me gjyshen



Nëna me profesionin infermiere



Babi që na rrëfeu për festën e Bajramit



Shfaqje – cirku me qen



Babi me profesionin e policit në klasë



Daja në kopsht me shfaqje teatrale



Babi me profesionin e bletarit në dhomë



Gjyshi shkrimtar në dhomë



Nëna me profesionin e mësueses së gjuhës angleze      Babi me profesionin e postierit në dhomë

### Faza III: Reflektimi

Gjatë zhvillimit të këtyre aktiviteteve morën pjesë pothuajse të gjithë fëmijët e grupit si dhe një numër i madh i prindërve dhe anëtarëve tjerë të familjeve.

Gjatë ditëve kur u realizuan aktivitetet, angazhimi i fëmijëve, disponimi dhe dëshira e tyre për lojë dhe aktivitete ishte mjaft i madh. Këto aktivitete mundësuan që fëmijët të komunikojnë më shumë me njëri-tjetrin, të zhvillojnë të menduarit kritik, të bëjnë pyetje dhe të diskutojnë për gjërat që janë me interes për ta.

Me rëndësi të veçantë ishin sidomos njohuritë që morrën për natyrën, këshillat për të mirat që sjell shetija në natyrë, rreziqet në natyrë, siç është pickimi nga insektet e ndryshme, alergjitë dhe ndikimi i natyrës në shëndetin e fëmijëve.

Mbi të gjitha të gjithë fëmijët kanë qenë pjesëmarrës dhe kanë ndarë bashkë me prindërit kënaqësinë dhe të mirat e prezencës së prindërve dhe familjarëve të tyre në shetije dhe dhomë.



## Sfidat dhe vështirësitë

Realizimi i aktiviteteve në natyrë dhe ftesa e shumë mysafirëve sollën vështirësi në organizimin e kohës, materialeve dhe përgatitjet rreth fëmijëve, në këtë rast duke pasur parasysh nevojat, kërkesat dhe moshën e tyre. Kërkohej që i gjithë stafi të angazhohet dhe të planifikonte çdo detaj në mënyrë që të gjitha aktivitetet të realizohen sipas planit.

# 3

## KOMPETENCA

## FAMILJA DHE KOMUNITETI

### Parimi

2.1 Edukatori/Mësuesi nxitë bashkëpunimin me familjet dhe ofron mundësi të larmishme familjeve e anëtarëve të komunitetit që të përfshihen në procesin e zhvillimit dhe të të nxënit.

### Treguesit

2.1.3. Edukatori/Mësuesi përfshin anëtarët e familjes në vendim-marrje që kanë të bëjnë me mjedisin mësimor.

### Aktivitetet/veprimtaritë edukative

Kafshët e buta

### Rezultatet e të nxënit

Fëmijët mësojnë se kafshët ashtu si dhe njeriu, kanë familjet dhe shtëpinë e tyre për të jetuar.

### Mosha e fëmijëve

3-6 vjeç

### Materiali i nevojshëm

Kafshë të ndryshme lodra, kafaz lepuri, qen, një kolibe të improvizuar për qenin, karrota, lakër, libra me ilustrime, kafshë të prera për ngjitje, ngjitës, pipëza të lëngjeve, ngjyra, letra

### Ndërlidhja e kompetencave

Ndërveprimi, përfshirja, diversiteti si dhe vlerat e demokracisë, strategjitë e mësimdhënies



## Faza I: Parapërgatitja

Pasi është vërejtur interesimi i fëmijëve për kafshët në ditët paraprake është vendosur që në javët në vazhdim të planifikohet tema rreth kafshëve të buta. Fillimisht është organizuar një takim me prindërit për të diskutuar rreth planit tonë për realizimin e temës dhe për të marrë ide dhe mbështetje edhe nga prindërit. Po ashtu konfrimuar për ndonjë alergji eventuale të fëmijëve ndaj kafshëve të buta. Takimi rezultoi me interesim të prindërve që të realizohet tema, dhe u siguria mbështetja e tyre përgjatë realizimit të aktiviteteve.

Në takim u vendos se në bashkëpunim me prindërit, mund të sjellim një lepur dhe një qen për disa ditë në kopsht. Poashtu u vendos që gjatë realizimit të temës të bëhet edhe një vizitë në Qendrën për Strehimin e Kafshëve Endacake në Harilaq, ku fëmijët mund të njihen më mirë me jetën e kafshëve.

Kafshët (një qen dhe një lepur) të sjella nga prindërit u vendosen në kopsht, duke u siguruar kushte të përshtshme për to.

## Faza II: Realizimi

Sjellja e kafshëve në kopsht ngjalli shumë entuziazëm dhe gëzim të fëmijët. Po ashtu fëmijët ishin shumë kureshtarë dhe parashtronin pyetje të shumta për kafshët. Fëmijëve u interesonte për ushqimin, gjumin pushimin, pastrimin dhe mënyrën e të jetuarit të tyre.

Dy ditë radhazi në kopsht kemi diskutuar vetëm për kafshët dhe jemi kujdesur për dy mysafirët tanë. Fëmijët i kanë ushqyer, kanë përcjellë çdo lëvizje të tyre, dhe tërë kohën kanë shprehur kujdes dhe i kanë përkëdhelur.

Lepuri dhe qeni ishin temat dhe angazhimet kryesore për këto ditë. Një nga prindërit ishte ftuar të jetë prezent gjatë këtyre dy ditëve, i cili prezantoi informtata të detajuara për të dy kafshët lidhur me jetëgjatësinë e tyre, ushqimin, gjumin etj.





Takimi i mëngjesit, njohja me lepurin dhe ushqimin e tij

Pas kësaj faze së bashku me disa nga prindërit realizuam një vizitë jashtë kopshtit, në Qendrën për Strehimin e Kafshëve Endacake në Harilaq.

Për te realizuar vizitën në strehimoren e kafshëve endacak u bënë të gjitha organizimet logjistike, me kujdes të veçantë për sigurinë e fëmijëve. Transporti u sigurua nga prindërit disa prej të cilëve na shoqëruan në këtë vizitë.

Gjatë vizitës, fëmijët ishin kurreshtarë të kuptojnë se kush kujdeset për kafshët e rrugëve dhe se kush mund të adoptojë ato.

Ata u njoftuan për trajtimin e kafshëve pa familje si dhe mënyrën e përkujdesjes ndaj tyre. Pati interesim gjithashtu të informohen me kohë që u duhet këtyre kafshëve të ambientohen në vendin e ri.



Gjatëvizitës së fëmijëve në Qendrën e Qenëve Endacak dhe përkujdesja ndaj qenit në kopsht

Të nesërmen, gjatë diksutimit në takimin e mëngjesit vërehej se fëmijët shprehnin më shumë dashuri për kafshët, dhe secili tregonte se ka dëshirë të ketë një kafshë dhe të kujdeset për të.

Realizimi i aktiviteteve në qendra:

Në qendrën e leximit, fëmijët shkruajnë në një fletë me ngjyra emrin e imagjinuar të kafshës së pëlqyer dhe e zbukurojnë atë me materiale të ndryshme dekoruese.

Në qendrën e blloqeve, fëmijët ndërtojnë “Qendrën për Strehimin e Kafshëve Endacake”, duke përdorur materiale të ndryshme recikluese si enë plastike, pipëzat e lëngjeve që paraqisnin rrethojat etj.

Në qendrën e artit, paraqitën përshtypjet nga vizita duke vizatuar me ngjyra temper të cilat i përdorurën me gishtërinj.

Në qendrën e matematikës, edukatorët paraprakisht vendosin figura të ndryshme të kafshëve (plastike dhe nga kartoni), të cilat fëmijët i kalsifikojnë sipas madhësisë dhe formave, dhe i emërojnë ato.

### Faza III: Reflektimi

Fëmijët kanë arritur të dallojnë kafshët e buta nga kafshet tjera dhe të mësojnë shumë rreth jetës së tyre si dhe se si duhet të përkujdesemi për to. Vizita në strehimore i ka bërë fëmijët të kuptojnë se kafshëve endacake u duhet trajtim i veçantë derisa të ambientohen me vendin e ri dhe me njerëzit. Sjellja e lepurit dhe qenit në kopësht ka ndikuar që edhe fëmijët tjerë të shprehin interesim për kafshët.

Përfshirja e prindërve qysh në fazën e planifikimit të aktivitetit ka ndikuar që prindërit të shfaqin interesim dhe përfshirje aktive gjatë gjithë realizimit të temës.

#### **Bazuar në aktivitetin tematik dhe interesimin e fëmijëve, u nxorën dy ide për t'i zhvilluar në ditët në vazhdim:**

1. Të ushqyerit e kafshëve: fëmijët do të sjellin ushqime të ndryshme nga shtëpitë e tyre dhe do të përgatisin ushqimin për lepurin dhe qenin për disa ditë. Në të njëjtën kohë do të bisedohet për vlerat që kanë këto ushqime për kafshët e caktuara.
2. Familja e kafshëve: Gjatë realizimit të kësaj (nën)teme do të bisedohej për dallimet ndërmjet jetës së kafshëve dhe të njerëzve dhe për familjet, duke filluar nga lepurit për të kaluar te njeriu. Më pas, fëmijët me vizatime shprehën bashkësitë e kafshëve dhe ato të njerëzve, të cilat i numëruan dhe i grumbulluan në forma të ndryshme.



# 4

## KOMPETENCA

## FAMILJA DHE KOMUNITETI

### Parimi 2.1

Edukatori/mësuesi nxit bashkëpunimin me familjet dhe ofron mundësi të larmishme familjeve dhe anëtarëve të komunitetit që të përfshihen në procesin e zhvillimit dhe të mësuarit të fëmijëve

### Treguesi/t 2.1.3

Edukatori/mësuesi përfshijnë anëtarët e familjes në vendim-marrje të përbashkëta në lidhje me procesin mësimor, zhvillimin dhe jetën në klasë të fëmijëve të tyre.

### Aktivitetet/veprimtaritë edukative

Rregullimi i ambientit

### Rezultatet e të nxënit

Nxit kreativitetin, marrin përgjegjësi dhe vetëdijësohen për ruajtjen e ambientit në dhomë dhe kopsht.

### Materiali i nevojshëm

Letra me ngjyra të ndryshme, material reciklues, spagë, projektor dhe kompjuter, ngjyra të ndryshme, materiale manipulative, etj

### Ndërlidhja e kompetencave

Ndërveprimi, Mjedisi mësimor



## Faza 1 - Parapërgatitjet

Kopshti ynë ka marrë vendim për rregullimin e ambientit të brendshëm si dhe shtimin e një hapësire për aktivitete dhe dhoma për fëmijë. Për të realizuar këtë u caktua një takim me prindërit për të diskutuar mundësitë e bashkëpunimit. Gjatë takimit u shpalosën shumë ide që erdhën nga prindërit, si: mundësia e gjetjes së fondeve shtesë, angazhimi i prindërve, dhe më interesantja kërkesa që edhe fëmijët të jenë pjesë e këtyre ndryshimeve. Një prind i cili me profesion është arkitekt shprehu dëshirën të përfshihej një ditë në aktivitet me fëmijët. Ajo premtoi se do të përgatisë një prezantim dhe disa aktivitete me fëmijët. Ishte interesant komenti i prindit se me këto aktivitete mund të kuptojmë çfarë interesime kanë fëmijët. U dakordua se prezantimi do të jetë pas një jave dhe ndërkohë prindi do të na kontaktojë në lidhje me materialet e nevojshme për të realizuar aktivitetin.

## Faza 2 - Realizimi

Deri sa fëmijët ishin duke ngrënë mëngjes, prindi së bashku me njëren edukatore përgatitën vendin e prezantimit dhe materialet për qendra. Këtë ditë u vendos që të mos punohet me qendra të aktiviteteve, por pas takimit të mëngjesit fëmijët të ndahen në tri grupe ku do të punonin rreth rregullimit të ambientit të kopshtit. Posa u kthyen, fëmijët u ulën në rreth dhe menjëherë filluan të bëjnë pyetje rreth materialeve të reja në dhomë, të cilat nxitën kureshtje tek ata. Prindi filloi prezantimin me projektor. Kishte përgatitur disa foto të ambienteve të ndryshme, duke filluar, nga shtëpia, kopshtet, lojëra të ndryshme, etj. Deri sa prezantoheshin fotot, prindi u tregonte fëmijëve dallimet e ambienteve të ndryshme të cilat ishin në foto. Fëmijët tërë kohën bënë pyetje për të sqaruar atë se çfarë shihnin.

Pas përfundimit të prezantimit, prindi së bashku me njëren edukatore zhvilluan një bisedë me fëmijët duke filluar me pyetjen: Po qe se rregullohet ambienti i kopshtit, si do të kishit pas dëshirë të dukej? Përgjigjet e fëmijëve ishin shumë interesante. Kishte kërkesa që kopshti të jetë më i madh dhe të vinin edhe prindërit tjerë për të kryer punime të ndryshme në mure të kopshtit, që në oborr të ketë një pishinë, të ketë më tepër lodra, të vendosen shtretërit në një dhomë të madhe ku të gjithë fëmijët e kopshtit do të pushonin së bashku, e të tjera pyetje nga më të ndryshmet.

Më pas fëmijët u ndanë në tri grupe. Grupi i I-rë do të japë ide për rregullimin e dhomës dhe do të ndihmohet nga njëra edukatore. Grupi i II-të do të japë ide për rregullimin e kopshtit dhe do të

punojë me prindin dhe grupi i III-të do të mendojë si ta rregullojmë korridorin hyrës në kopshtin tonë së bashku me edukatoren tjetër. Fëmijët u ndanë sipas përzgjedhjes së ngjyrave të cilat ishin në një kuti të mbyllur. Atyre që u ra ngjyra e gjelbër shkuan në grupin e I-rë, atyre me ngjyrë portokalli me grupin e II-të dhe ata me ngjyrë kafe me grupin e III-të.

Për të gjitha grupet paraprkisht ishin përgatitur materialet. Në grupin e I-rë edukatorja kërkoi që fëmijët në çifte të punonin një punim me temën “si duket dhoma jonë”. Punimi u punua me mjete manipulative të cilat i morëm nga qendra e matematikës. Fëmijët filluan punimin në çifte dhe pas një kohe, në një fletë të madhe të gjithë i bashkuan idetë dhe kjo falë pyetjeve të edukatoreve.

Grupi i dytë vendosi të dalë jashtë në kopsht së bashku me prindin dhe të vëzhgojë pamjen e ambientit. Ata së pari vizituan çdo hapësirë të kopshtit dhe më pas filluan të japin ide. Prindi kishte përgatitur edhe materiale të cilat do të nxisnin të menduarit tek fëmijët.

Ajo kishte sjellë materialet e nevojshme për aktivitet si: spagë, letra me ngjyra dhe formate të ndryshme, shpuza të mëdha etj.

Fëmijët filluan të jepnin ide të cilat ishin shumë kreative. Erdhën me ide se në kopsht duhet të ketë një luhajë të gjatë, të punuar me goma, një hapësirë e vogël me ujë, një shteg për biçikleta, një vend ku fëmijët mund të ngjiten, etj.

Grupi i III-të dha ide se të gjithë dollapët e rrobave mund të vendosen në korridor, pasi që korridori është shumë i madh. Po ashtu u dhanë ide të vendoset një tavolinë dhe karrige për prindërit, dhe aty të vendosen disa lodra me të cilat fëmijët mund të luajnë

Pas rreth një ore të gjithë fëmijët u grumbulluan përsëri në dhomë dhe ndanë idetë me të tjerët.

Çdo grup kishte përzgjedhur nga një prezantues, ndërsa fëmijët tjerë të grupit ndihmonin gjatë prezantimit. Kjo ishte pjesa më e bukur e aktivitetit ditor, sepse të gjithë ishin shumë krenarë me punën që kishin bërë.

Gjatë kësaj kohe prindi dhe një edukatore mbajtën shënime për ato se çfarë prezantuan fëmijët për të mbledhur idetë dhe punën e tyre për prezantim në tabelën e punimeve në dhomë.



### Faza 3 - Reflektimi

Si për fëmijët ashtu edhe për edukatorët organizimi i aktiviteteve për të marrë idetë e fëmijëve për rregullim të ambientit ishte shumë interesant. Ideja e prindërve që në këtë proces të përfshiheshin fëmijët ishte shumë me vend. Nga nevojat dhe dëshirat e fëmijëve dolën edhe shumë ide të cilat me siguri se nuk do t'i parashihnin. Mbetet që ekspertja/arkitektja, këto ide të fëmijëve t'i paraqes në një plan të cilin shumë shpresojmë se do ta realizojmë.

#### Alternativa tjera për zhvillim të aktivitetit:

Ky koncept i rregullimit të ambientit do të ishte mirë të bëhet me të gjitha grupet e kopshtit, ashtu që të marrim ide edhe nga fëmijët tjerë dhe të bëhen ndryshime në mjedisin e kopshtit me ndihmën edhe të prindërve si bashkëpunëtorë.



# 5

## KOMPETENCA

## FAMILJA DHE KOMUNITETI

### Parimi 2.1

Edukatori /mësuesi nxit bashkëpunimin me familjet dhe u ofron mundësi të larmishme familjeve e anëtarëve të komunitetit të përfshihen në procesin e zhvillimit dhe të nxënit

### Treguesi/t 2.1.2

Edukatori /mësuesi përfshinë anëtarët e familjes në vendim-marrje të përbashkët në lidhje me procesin edukativ, zhvillimin dhe jetën sociale në dhomë/klasë të fëmijës së vet

### Aktivitetet/veprimtaritë edukative

Pranvera - punët në pranverë

### Rezultatet e të nxënit

Përkujdeset për bimët

Njih dhe tregon veglat e punës se bujkut

Dallon pjesët e bimëve dhe farat e tyre.

Bashkëvepron me të rriturit, bashkëmoshatarët dhe me edukatoret.

Shpreh emocione gjatë aktivitetit, respektojnë njëri tjetrin,

Merr përgjegjësi për punën që bën.

### Materiali i nevojshëm

Vazo, lule dhe bimë të tjera, lopata, kova uji, fara të luleve, fidane të pemëve dhe perimeve

### Kohëzgjatja

Katër javë

### Ndërlidhja e kompetencave

Ndërveprimi, planifikimi dhe vlerësimi, mjedisi mësimor.



## Faza 1 - Parapërgatitjet

Fillimisht ftuam prindërit në një takim ku diskutuam për veprimtaritë edukative që do zhvillohen këtë muaj e që fokus kanë temën “Pranvera dhe punët që bëhen gjatë kësaj stine”. Në takim morën pjesë 18 prindër, aty shpalosëm planin dhe programin e punës njëmuajore. Prindërit dhanë ide shumë të qëlluara për të pasuruar veprimtaritë, si vizita në fshat dhe lulishte, shprehën gatishmërinë që të kontribuojnë për realizimin e planit mujor. Në bashkëpunim me prindërit realizuam këto vizita: në Institutin Hidrometeorologjik, në barnatoren bujqësore, në fshat, në lulishte, në parkun e qytetit.

Poashtu prindërit na ndihmuan në sigurimin e materialeve të nevojshme lidhur me veprimtaritë edukative duke sjellë: fara të ndryshme për mbjellje, dhe, vazo, lopata, lule, fidane pemësh e të tjera.

## Faza 2 – Realizimi

Gjatë kësaj javë realizuam disa aktiviteteve që u zhvilluan në grup se bashku me tre prindër vullnetarë të cilët mundësuan vizitën në fshat. Nga kjo vizitë fëmijët mësuam se si bëhet përgatitja për mbjellje që nga lëvrimi i arës, e deri tek hedhja e farës. Po ashtu u njoftuan me mjetet e nevojshme të punës dhe mënyrën e përdorimit të tyre. Pas dy ditëve, me ndihmën e prindërve vizituam barnatoren bujqësorë ku dhe siguroam materialet e nevojshme për aktivitetin që realizuam.

Fillimisht edukatorja përmes një kënge i ftoi fëmijët të ulen në rreth për takimin e përbashkët, dhe vazhdoi me realizimin e aktivitetit të planifikuar. Vlen të theksohet që kjo temë dhe aktivitetet kishin filluar para një jave. Edukatorja me ndihmën e një prindi paraprakisht kishin përgatitur disa ilustrime të bimëve dhe kishin sjellë disa bimë. Së bashku parashtruan pyetje të cilat nxitën të menduarit kritik tek fëmijët si: çfarë po shohin në ilustrim, a ju pëlqejnë bimët, cila nga këto bimë ose edhe të tjera keni pasur rast t’i shihni, çka ju nevojitet bimëve që të rriten, si kujdesemi për bimët, a i përdorim bimët në kuzhinë apo për ilaçe, a keni mbjellë ju ose dikush nga familjarët tuaj ndonjë bimë? Më pas vazhduan pyetjet për bujkun si: kush është bujku, çfarë pune bën ai, cilat mjete përdor etj?

Përmes këtyre pyetjeve ne morëm informacione se sa kanë informata fëmijët për bimët, si dhe i informuam ata për dobitë dhe kujdesin ndaj bimëve. Kjo bisedë po ashtu u mëson fëmijëve të flasin me rradhë, të respektojnë mendimin e njëri tjetrit, si dhe të mësojnë se si duhet të jenë të përgjegjshëm ndaj natyrës.

Pas diskutimit në grup fëmijët së bashku me edukatorët dhe prindin, shkuan në oborr ku ishin edhe dy prindër tjerë. Aty të gjithë së bashku realizuam mbjelljen e farëve dhe fidaneve të bimëve të ndryshme të cilat i siguroam në barnatoren bujqësore dhe disa që i kishin sjellë prindërit.

Prindërit kishin sjellë edhe mjetet e punës që na nevojiteshin për mbjelljen e farave. Një prind u shpjegoi fëmijëve se për çka përdoren këto mjete dhe si quhen. Secili prej fëmijëve kishte fara të ndryshme si fara: misri, gruri, tranglli, domateje, lulesh të ndryshme etj. Me ndihmën e prindërve filluan përgatitjen e tokës për mbjellje.

Disa fëmijë gërmonin dheun, disa bënë vrira për mbjelljen e farave apo fidaneve e disa kishin me vete kova me ujë që t'i ujin pas mbjelljes së farës. Gjatë kësaj kohe fëmijët u bënë shumë kureshtarë dhe kishin shumë pyetje. Ishin prindërit ata që përgjigjeshin dhe ndihmonin në shpjegime. Komentet që veçuam ishin: Kush do të kujdeset për bimët natën, a do të jenë nesër të rritura?

Pasi që u mbollën farat dhe u ujitën, fëmijët pastruan duart dhe u kthyen në dhomë ku vazhduan me aktivitetet në qendra. Për këto aktivitete fëmijët u ndanë në 4 qendra.

Tek qendra e artit me materiale recikluese modeluan disa lule, fidane, fara dhe mjete pune, tek qendra e matematikës zgjodhën nga një numër për të përcaktuar farat që kanë mbjellë dhe me tapa ose kapakë të shisheve formuan aq fara të bimëve sa kishin të gjithë fëmijët, kështu që patën rastin të përcaktojnë numrin dhe të mbledhin.

Tek qendra e blloqeve ndërtuan një kopsht me pemë dhe perime, improvizuan mjetet e punës, ndërsa tek qendra e leximit fëmijët përmes disa letrave të përgatitura nga edukatorja ku ishin shkruar fjalët: farë, grurë, bimë, perime, bujk dhe pemë bashkuan me anë të kapëseve të rrobave letrat që shënojnë shkronjat përkatëse dhe figurat e ilustruara.

Pas përfundimit të këtyre aktiviteteve në qendra secili fëmijë ekspozoi punimin e vet dhe në fund u zhvillua takimi përmbyllës për përshtypjet e ditës nga fëmijët dhe prindërit prezent. Në përmyllje të takimit u bë një reflektim i shkurtër, një vlerësim dhe një vetëvlerësim nga fëmijët duke u shoqëruar çdo herë me inkurajimin dhe lëvdatat nga mësueset për gjithë punën e bërë nga fëmijët si dhe për kontributin e prindërve.

Po ashtu biseduam për përgjegjësitë tona ndaj farave dhe fidaneve të cilat i mbollëm sot. Në fund caktuam orarin e përkujdesjes së bimëve të mbjella dhe fëmijët ndanë rolet dhe përgjegjësitë e tyre.



### **Këndëvështrimi i fëmijës/ prindit:**

Fëmija im ka qenë shumë i kënaqur me aktivitetin që është zhvilluar dhe ishte i lumtur që sot ka mbjellur një fidane dhe ka marrë informata se si bëhët dhe çka nevojitet për të mbjellë dhe kultivuar një farë/fidane.

Edhe unë u kënaqa me fëmijën tim dhe shokët e shoqet e tij deri sa punuam në oborr dhe mbollëm fara. Shpresoj që këto fara të sjellin fryte dhe fëmijët t'i shijojnë ato.

Sa shumë jam kënaqë por edhe jam lodhë duke punuar jashtë.

E kam prek dheun dhe kjo ishte një ndjenjë e mirë.

### **Faza 3 - Reflektimi**

Prezent ishin 20 fëmijë dhe tre prindër. Të gjithë fëmijët morën pjesë në aktivitete duke shprehur entuziazëm dhe përkushtim. Për shumicën nga fëmijët ishte përvoja e parë në punë në kopsht dhe se kjo u dha kënaqësi të përdorin mjetet, të përpunojnë tokën dhe të njihen me bimët dhe farat.



# Kompetenca 3-3



# 1

## KOMPETENCA

## PËRFSHIRJA, DIVERSITETI DHE VLERAT E DEMOKRACISË

### Parimi

3.2 Edukatori/mësuesi ndihmon fëmijët të kuptojnë, të pranojnë dhe çmojnë diversitetin

### Treguesit

3.2.1. Edukatori/mësuesi çmon dhe përfshin në mësimdhënie diversitetin që ekziston mes fëmijëve, familjeve dhe brenda komunitetit

### Emri I aktivitetit

Unë dhe familja ime

### Rezultatet e të nxënit

Emërton anëtarët e familjes dhe njihen me llojet e familjeve

### Materiali i nevojshëm

Fleta t; bardha, ngjyra, lapsa, libra me ilustrime

### Ndërlidhja e kompetencave

Ndërveprimi, familja dhe komuniteti



## Parapërgatitjet:

Një familje është burim i dashurisë dhe sigurisë për një fëmijë. Fëmijët kanë dëshirë të madhe të flasin për familjet e tyre, të tregojnë histori të ndryshme familjare të cilat i përjetojnë në vazhdimsi. Për të realizuar këtë aktivitet prindërit janë njoftuar me kohë dhe është kërkuar që edhe ata të kontribuojnë si në klasë po ashtu edhe në shtëpi, ashtu që të flasin me fëmijët për familjet dhe trashëgiminë. Aktivitetet u përgatitën të zhvillohen përmes lojërave të ndryshme nëpër qendra të aktiviteteve si dhe gjatë takimit të përbashkët. Loja si mjet edukimi dhe mësimi është mjet kryesor, sepse fëmijët e duan dhe në lojë angazhohen me dëshirë dhe sipas interesit apo kureshtjes. Loja vë në bashkëveprim fëmijët me njëri –tjetrin dhe bazohet në skenarin e përgatitur ku fëmijët e një grupi kanë rolet e tyre.

## Realizimi

Të gjithë fëmijët ulen në formë rrethi në takim të mëngjesit duke u përshëndetur me njëri –tjetrin. Plotësojmë kalendarin, duke diskutuar për karakteristikat e stinës dhe veçoritë ditës në të cilën ata janë. Edukatorja u drejtohet fëmijëve me disa pyetje të hapura: Kush ju sollti juve sot në kopsht? Kush kujdeset për ju, me kë jetoni në shtëpi? Kështu gradualisht lidhemi me temën që do të zhvillojmë. Në klasën tonë kemi kukullën e cila shpesh na viziton dhe quhet Stani. Kukulla nuk qëndron tërë kohën në klasë, ajo është prezente vetëm kur kemi nevojë apo dëshirë që fëmijëve t'u flasim për tema të ndryshme. Ajo përdoret edhe nga grupet tjera. Kukulla jonë është me ngjyrë të zezë dhe ka syze dhe fëmijët e pëlqejnë shumë.. Kukulla gjithnjë i flet njëres edukatore në vesh dhe edukatorja paraqet para fëmijëve atë që tregon ajo. Kukulla Stani për këtë temë u përdor për t'u treguar fëmijëve se ai jeton vetëm me nënën sepse babi i tij kishte ndërruar jetë, por ai është shumë i lumtur në familjen e tij të vogël. Ishte moment shumë i mirë që me fëmijët të bisedonim edhe për ndjenjat. Kështu u diskutua për pyetjet se si është ndjerë Stani kur ka humbur të atin, si ndihet tani, sa kujdeset ai për nënën dhe nëna për te, etj. Fëmijët kishin shumë pyetje dhe po ashtu shprehën empati, pra bashkëndjenë dhembjen e Stanit. Më pas të gjithë kishin dëshirë të flisnin për familjet e tyre dhe për atë se si ndihen në familjet e veta. Disa përmendën edhe gjyshërit me të cilët jetonin. Shumë shpesh treguan për sigurinë që gjejnë në familje, sidomos kur janë të frikësuar ose kanë shqetësime. Kishte edhe fëmijë që komentonin se prindërit e tyre kanë ndonjëherë edhe veprime të papranueshme për ta si p.sh, shpesh bërtasin pa nevojë, nuk marrin parasysh mendimet e tyre, etj.



Pastaj diskutuam rreth mbiemrit, meqenëse zakonisht familja identifikohet me mbiemër. Ishte interesant shpjegimi kur edukatorja tregoi se ajo mban mbiemrin e vajzërisë, ndërsa anëtarët tjerë kanë mbiemrin e njejtë.

Po ashtu diskutuam se ku jetojnë familjet dhe çka i lidh ato dhe se jo çdo familje ka lidhje gjaku. Shpjeguam edhe për adoptimin e anëtarit të familjes. Fëmijët e kishin vështirë të kuptonin procesin e adoptimit, andaj ne u shpjeguam me një qen i cili në një familje është bërë anëtarë i tyre. Më pas diskutuam edhe për të drejtat dhe përgjegjësitë që kanë anëtarët e familjeve, respektimin mes tyre, ndarja e detyrave në shtëpi si ujitja e luleve, rregullimi i shtratit, e të tjera.


Edukatorja ofroi një ilustrim të pemës së familjes, dhe të gjithë së bashku vizatuam familjen e Stanit, ku përpos nënës e plotësuam edhe me gjyshërit e tij.

Pas kësaj kërkojmë që fëmijët të shpërndahen në qendra dhe paraprkisht u tregojmë se në **qendrën e artit** do të vizatojnë familjen e tyre, kurse në **qendrën e gjuhës** do të plotësojnë tringun familjar me vizatime ose shkronja.

Në **qendrën e matematikës** paraprkisht, me numra do të paraqesin anëtarët e familjes dhe në grup, do të punojnë në një fletë, ku do të numërojnë anëtarët e të gjithë grupit. Në **qendrën e familjes** do të paraqesin një ditë të zakonshme dhe obligimet e secilit anëtar, ndërsa në **qendrën e blloqeve** do të ndërtojnë një shtëpi që do të plotësojë nevojat e të gjithë anëtarëve të familjes.

Gjatë përcjelljes për në shtëpi u kërkojmë prindërve që të diskutojnë me fëmijët për origjinën e familjeve të tyre, për të kuptuar dhe shpjeguar ndryshimet që ka pësuar familja ndër vite, nga familje të mëdha me shumë anëtarë në familje me më pak anëtarë.

Po ashtu u kërkojmë që të sjellin nga një foto të cilat do t'i vendosim në mur si dhe një gjësend nga shtëpia që ka kuptim për familjen e tyre të cilën nesër fëmijët do ta prezantojnë para tjerëve.



### Reflektimi:

Fëmijët kuptuan llojet e familjeve. Kjo temë do të zgjatë edhe disa ditë. Pas përfundimit të ditës së parë gjatë reflektimit vendosëm që një ditë në vijim të ftojme ndonjë gjysh apo gjyshe të flasin për familjet dikur dhe tani. Fëmijë kuptuan se në familje të gjithë duhet të gëzojnë të drejta pa dallim. Po ashtu fëmijët patën rastin të flasin edhe për ndjenjat e që është element shumë i rëndësishëm për të krijuar një personalitet stabil.

Përdorimi i kukullës është mjet shumë i mirë për të prezantuar temat të cilat ndonjëherë është vështirë të diskutohen me fëmijët, këto tema zakonisht paraqiten si elemente që kukulla i ka përjetuar dhe dëshiron t'i ndajë me fëmijët. Kjo u ndihmon fëmijëve për të kuptuar se edhe të tjerët përjetojnë gjëra të ndryshme si vetminë, humbjen, diversitetin, etj.

# 2

## KOMPETENCA

## PËRFSHIRJA, DIVERSITETI DHE VLERAT E DEMOKRACISË

### Parimi

- 3.1 Edukatori/mësuesi ofron mundësi të barabarta për çdo fëmijë dhe familje që të mësojnë dhe të marrin pjesë pavarësisht nga gjinia, raca, origjina etnike, kultura, gjuha, feja, struktura familjare, statusi social, statusi ekonomik, moshë, ose nevojat e vecanta.
- 3.2. Edukatori/mësuesi ndihmon fëmijët të kuptojnë, pranojnë dhe vlerësojnë diversitetin.

### Treguesit

- 3.1.2. Edukatori/mësuesi trajton çdo fëmijë me respekt, dinjitet dhe konsideratë dhe siguron mundësi të barabarta për secilin për t'u angazhuar në jetën e shkollës/kopshtit.
- 3.2.1. Edukatori/mësuesi vlerëson dhe përfshinë në mësimdhënien e tij/saj diversitetin që ekziston në mes fëmijëve, familjeve dhe brenda komunitetit.

### Aktivitetet/ veprimtaritë edukative

- Ndjenja e sigurisë:  
Ambientet mbrojtëse dhe të sigurta

### Rezultatet e të nxënit

- Njihen me konceptin sigurt dhe jo sigurt.  
Flasin në grup për veten dhe ndjenjat e tyre.  
Njohin më shumë vehten dhe të tjerët.  
Imagjinojnë dhe krijojnë ambiente të sigurta për vehten e tyre.  
Shprehin kreativitet në punimet e tyre.  
Mësojnë të pranojnë tjetrin ashtu siç ai/ajo është duke mos e injoruar apo larguar nga loja.  
Marrin vetëiniciativë për të krijuar dhe dizajnuar lojën.  
Mësojnë se sa të ndryshëm dhe sa të ngajshëm janë.

### Materiali i nevojshëm

- Libra me ilustrime, figura me trupin e njeriut, fleta të bardha, ngjitës, material me aroma dhe shije të ndryshme, si: limon, sheqer, krip, parfum, etj.

### Ndërlidhja e kompetencave

- Ndërveprimet, Familja dhe komuniteti, Strategjitë e mësimdhënies



## Faza I: Parapërgatitja

Duke u nisur nga diversiteti që kemi në grup është mjaft e nevojshme dhe e arsyeshme të zhvillohen lojëra dhe aktivitete të ndryshme të cilat do të ndihmojnë në identifikimin e dallimeve dhe ngajshmërive si dhe ndjenjave që përjetojmë nga ndryshimet. Me anë të aktiviteteve që do të zhvillohen gjatë javës do të krijohet një ambient i sigurtë për të gjithë.

Në të njëjtën kohë fëmijët do të nxiten për të kuptuar përgjegjësitë dhe kujdesen për vetën dhe për të tjerët. Aktivitetet dhe lojërat do të zgjasin gjatë një jave, nga e hëna deri të premten. Tema do të realizohet duke përdorur këndvështrimin e fëmijëve, pyetje dhe diskutime, tregime e ngjarje, aktivitete artistike, personazhe kukulla, vallëzim, lëvizje, muzikë etj. Pra, do të jenë të përfshira të gjitha fushat e zhvillimit të fëmijëve në një apo formë tjetër.

## Realizimi

Biseda jonë rutinore filloi si zakonisht në rreth në takim të mëngjesit. Për hyrje në temë u morën si shkas bisedat dhe tregimet e fëmijëve për vizitat, shëtitjet dhe ngjarje të ndryshme që kanë përjetuar gjatë fundjavës së kaluar.

Pas rrëfimeve të secilit nga fëmijë, edukatorja i nxiti ata për të vazhduar bisedën dhe orientoi hyrjen në temë me anë të disa pyetjeve si:

Çfarë do të thotë të jeshë i/e sigurtë?

Çfarë ju bën të ndjeheni të sigurtë? Ku ndjeheni të sigurtë? Pasi mori disa përgjigjeje edukatorja u tregoi për vete se kur ndjehet e sigurtë dhe kur jo.

Cilat lloje të sjelljeve janë lënduese sipas jush?

A ndodhë që ndonjëherë ne të bëjmë sjellje që i lëndojnë të tjerët?

Kush mund të na ndihmojë?

Si ndiheni kur shihni se dikush lëndohet? A ka ndonjë gjë apo person që ju bën të ndjeheni të sigurtë, etj.

Më pas u tregoi për një ngjarje kur një fëmijë ishte lënduar nga një shok/shoqe dhe u kërkoi të

mendojnë për këtë situatë. Kërkuam që të japin mendimet se si ndihet fëmija i lënduar dhe si do të duhej të sillëshin të dy fëmijët. Është shumë me rëndësi që ne mos të ndërhyjmë me dhënie të përgjigjeve apo të zgjidhjeve për këtë situatë, por të kërkojmë që vetë fëmijët të mendojnë dhe ta ketë mndësinë të flasë.

Ata flasin, dhe japin mendimet e veta dhe në këtë mënyrë nxitet një debat i mirëfilltë që na ndihmon të njohim më mirë botën e tyre në përgjithësi, si dhe ata të kuptojnë nga njëri tjetri për konceptet thelbësore të emocioneve dhe të sigurisë. Njëra edukatore mbajti shënime për diskutimin në mënyrë që kur të analizojmë reflektimet dhe përgatitjet të kishim sa më shumë informacione të qarta rreth problematikës në përgjithësi.

Aktiviteti pasues është vizatim dhe ngjyrosje. Materiali i nevojshëm: fletë të bardha, lapsa, ngjyra të ndryshme, brusha, ujë në gota për ngjyrosje etj.

Secili nga fëmijët e ndau fletën në mes me një vijë ose simbol që ai preferoi dhe në njërën anë vizatoi diçka që simbolizon ambient të sigurtë për të, ndërsa në anën tjetër atë jo të sigurtë. Vizatimi mund të përmbajë vend, person, kafshë, ose çfarëdo që për fëmijën simbolizon siguri dhe jo siguri.

Pas vizatimit secili nga fëmijët zgjedhi nëse do ngjyros apo jo dhe dhe me çfarë ngjyra.

Pas përfundimit të vizatimeve, kërkuam se kush dëshironte të ndajë punimin me të tjerët dhe flolën vetëm ata që u ndjenë rehat t'i komentojnë ato. Është me rëndësi që të trajtohen dhe komentohen me kujdes rastet, nëse fëmijët paraqesin si ambient të pasigurtë ambientin e shtëpisë, apo prindin dhe të mos paragjykojnë në prani të klasës.

Ndërsa ditë tjetër fëmijët u njoftuan që sot, klasën do ta shndërrojnë në vendin e tyre të sigurtë/pasigurtë. Fëmijëve u shpjegohet që do të punojnë në grupe për të krijuar këndet e tyre të sigurta/të pasigurta. Grupi prej 24 fëmijëve ndahet në 4 grupe, duke caktuar grupet në mënyrë të rastësishme si psh: në një thes të vogël fusim 24 ngjyra druri dhe nga to vetëm 4 ngjyra të kuqe, 4 të gjelbërta, 4 të kaltërta dhe 4 të verdha. Fëmijët fusin dorën, marrin ngjyrën dhe fëmijët që kanë ngjyra të njëjta në dorë i takojnë të njëjtit grup.

Fëmijët e ndarë nëpër grupe fillojnë të diskutojnë se si dëshirojnë të ndërtojnë këndin e tyre të sigurtë, sipas preferencës së tyre. Fillimisht udhëzohen të diskutojnë për vende dhe kohëra të ndryshme, dhe pastaj të vendosin se si do të duket këndi (kasollja, shtëpiza) e tyre dhe të përcaktohen për emrin e këndit dhe të grupit të tyre. Pastaj fillojnë ta pajisin këndin me mjete, materi-



ale recikluese dhe lodra të ndryshme si dhe kukulla që simbolizojnë personat. Gjate bisedës që zhvillojnë fëmijët, edukatorja qëndron afër për të mbështetur fëmijët nëse kanë nevojë. Në fund të aktivitetit/lojës, fëmijët zgjedhin prezantuesin e grupit, i cili prezanton përpara klasës atë që grupi ka paraqitur.

Aktiviteti vazhdoj me 4 kukulla të veçanta që i kemi në dhomë dhe që përdoren për të dramatizuar tema si respektimi i diverzitetëve, e që secila ka tipare dhe ngjyrë tjetër, si dhe janë të dy gjinive. Të gjitha kukullat kanë emra dhe këta emra janë vendos nga vetë fëmijët, Iliri, Teuta, Kim, Xhoana. Bazuar në ditët paraprake edukatorët kanë sado pak ide rreth asaj se çfarë fëmijët mendojnë për sigurinë e tyre, pranë kujt dhe me kend ndihen të sigurtë, me kend preferojnë të luajnë më shumë, e shumë gjëra të tjera për të cilat mësuesja duhet të i marrë si shkas për të biseduar në grup.

Për këtë përdoren kukullat për të shtjelluar preokupimet që kanë dalë nga aktivitetet paraprake. Edukatorja merr kukullën afër vetes dhe dëgjon se çfarë i thotë në vesh në lidhje me brengën e saj. Brengat paraqesin shqetësimet e fëmijëve të cilat edukatorët i kanë analizuar nga shënimet e tyre gjatë ditëve paraprake. Edukatorja i interpreton fjalët e thëna gjëja se nga kukulla. Gjatë interpretimit fëmijët dëgjojnë me vëmendje dhe bëjnë pyetje të shumta, komente dhe japin ide se si të zgjidhet brenga ose problemi i adresuar. Biseda duhet të jetë e lirë dhe e hapur për të gjithë. Me anë të këtyre bisedave adresohen komentet apo shqetësimet që kanë fëmijët.

Aktiviteti tjetër që u zhvillua ishte loja “ Ishujt e mbrojtur “, këtë lojë e zhvilluam në sallë të kopshtit për shkak hapësirës më të madhe. Në dysheme vendosëm katër hamera ose letra të mëdha, të ngjyrosura nga fëmijët e të improvizuara në një ishull. Këto vizatime janë realizuar në dhomë paraprakisht. Fletat që paraqesin ishujt u vendosën në katër pozita të ndryshme të sallës. Fëmijët u informuan në detaje për rregullat e lojës. Ata duhet të imagjinojnë që salla është një oqean me plot gjallesa të ndryshme dhe të rrezikshme.

Kemi 4 ishuj që janë shpëtimi ynë në rast rreziku. Kur muzika fillon fëmijët ecin ngadalë (notojnë) me duar të hapura e kur ndalet muzika rrezikohemi nga gjallesa të ndryshme dhe fëmijët hyjnë në ishuj. Kur muzika fillon fëmijët dalin përsëri në oqean, ndërsa ne e largojmë njërin nga ishujt dhe kështu me radhë deri sa të mbetet vetëm një ishull në mes. Fëmijët në fund duhet të qëndrojnë të gjithë pavarësisht ndryshimeve, nevojave dhe mospajtimit, pra bashkë në të vetmin ishull që ka mbetur. Pas lojës u kërkuan mendimet e fëmijëve se si u ndjenë dhe a e ndihmuan njëri tjetrin.

## Reflektimi

Fëmijët arritën të bëjnë pyetje, krijuan debate ne grup. Mësuan fjalë dhe koncepte të reja. Njohën me shumë veten dhe shokët e grupit, si dhe shprehën empati ndaj njëri-tjetrit

Po ashtu edukatoret mësuan shumë për fëmijët. Fëmijët shprehen kreativitetin e tyre në fusha të ndryshme. Bashkëbiseduan dhe bashkëvepruan për një qëllim të vetëm, pranimin dhe çmuarjen e diversitetit mes nesh.

Të gjitha aktivitetet e realizuara në dhomë ose në ambientet brenda kopshtit do të ishte mjaft mirë të realizoheshin në natyrë në mënyrë që për fëmijët të jetë më interesant.

### Vështirësitë dhe sfidat:

Nuk ka pasur vështirësi të mëdha të cilat do të pengonin zhvillimin e aktivitetit. Dy nga fëmijët e grupit, për shkak të vështirësive për të shprehur ndjenjat komunikimit gojor, përdorëm teknika tjera të komunikimit me anë të vizatimeve që edhe ata të shprehin atë që ndjejnë.

### Informata të rëndësishme:

Një fakt që ne duhet të kemi parasysh sa herë që flasim për ndjenjat është se ato duhet të respektohen dhe të jenë gjithnjë të mbrojtura. Nëse njëri nga fëmijët nuk dëshiron të shprehet para të tjerëve, ne duhet të respektojmë këtë kërkesë a nevojë.





# 3

## PRAKTIKË E MIRË

### KOMPETENCA

### PËRFSHIRJA, DIVERSITETI DHE VLERAT E DEMOKRACISË

#### Parimi

3.2 Edukatori/mësuesi ndihmon fëmijët të kuptojnë, pranojnë dhe vlerësojnë diversitetin

#### Treguesit

3.2.1 Edukatori/mësuesi çmon dhe përfshin në mësimdhënje diversitetin që ekziston mes fëmijëve, familjeve dhe brenda komunitetit.

#### Aktivitetet/ veprimtaritë edukative

Jemi të ndryshëm por të barabartë

#### Rezultatet e të nxënit

Fëmijët diskutojnë dhe njohin të drejtat e tyre

#### Materiali i nevojshëm

Letra të bardha, letra më ngjyra, ballona, kukulla të fëmijëve të racave të ndryshme, ngjitës, materiale recikluese, revista, pamje të ndryshme të fëmijëve të ndryshëm

#### Ndërlidhja e kompetencave

Planifikimi dhe vlerësimi, Strategjitë e mësimdhëniës; mjedisi i të nxënit, ndërvëprimi



## Faza 1- Përgaditjet

Pasi kemi planifikuar temën javore me titull “Jemi të ndryshëm por të barabartë”, prindërit u njoftuan përmes letrave për planifikimin javor si dhe u ftuan të japin ide se çka mundën të kontribuojnë gjatë realizimit të kësaj teme.

Fillimisht u përgatit planifikimi ditor, u përzgjedhën metodat e punës, mjetet e nevojshme për këtë aktivitet, si dhe me ndihmën e prindërve u siguruan materialet e nevojshme. Disa nga prindërit u angazhuan në sjelljen e fotove të njerëzve, të racave të ndryshme, prejardhjes, gjinive, si dhe aftësive të kufizuara.

## Faza 2- Përshkrimi i realizimit të aktivitetit

Pasi edukatorja/mësuesja ka dhënë një sinjal me tingujt e një kënge fëmijët kanë kuptuar që është koha e takimit të përbashkët.

Të gjithë u ulën në karrigë në formë të një rrethi. Pasi perfundojnë rutinat ditore të takimit të mëngjesit, edukatorja/mësuesja fillon të prezantojë temën deri sa në dorë mbante disa fjali të shkruara në fleta të bardha, e që ishin disa nga të drejtat e fëmijëve të paraqitura edhe me ilustrime.

Edukatorja/ Mësuesja kërkoi nga fëmijët të japin mendime për të drejtat e fëmijëve, se cilat të drejta ata i njohin, cilat të drejta i gëzojnë si dhe a duhet të gjithë fëmijët t'i gëzojnë këto të drejta.

Për të ndërlidhur temën edukatorja/mësuesja nxiti bisedën edhe me pyetje të hapura për ndryshimet që kemi secili në grup, duke theksuar, ngjyrën e flokëve, madhësinë, gjininë, aftësinë e kufizuar, e pyetje tjera në lidhje me ndryshimet që kemi të gjithë ne.

Më pas edukatorja kërkoi që fëmijët individualisht, të provojnë të mendojnë një të drejtë apo edhe të përsërisin ato që dëgjuan.

Fëmijët cekën disa të drejta e që disa prej tyre ishin edhe dëshira, si, e drejta e të ushqyerit, të shikuarit të televizionit, të pasurit e një kafshe shtëpiake, e drejta për lojë, të cilat pastaj së bashku i diskutuam se a janë të drjeta apo dëshira.

Aktiviteti vazhdoi me një prind të komunitetit turk nga një klasë tjetër, i cili u ftua në klasë për të

njoftuar fëmijët me gjuhën turke. Me te ishte edhe fëmija i tij. Fillimisht prindi i ftuar në klasë filloi të flasë me vajzën e saj në gjuhën turke dhe fëmijët tjerë u interesuan për gjuhën me të cilën komunikuan. Me pas prindi u tregoi fëmijëve për gjuhën turke dhe i mësoi ata për disa shprehje si mirëdita, faleminderit, (günaydin dhe teşekkürler) etj. Ishin interesante komentet e disa fëmijeve të cilët njohën gjuhën nga televizioni.

Më pas me ndihmën e nënës mysafire shënuam në dy letra këto dy shprehje dhe vizatuam figura që ilustrojnë ato dhe i vendosëm në korridorin jashtë klasës, ashtu që edhe fëmijët tjerë t'i shohin dhe të mësojnë fjalët e reja në gjuhën turke.

Pas kësaj faze fëmijët u ndanë në qendra të aktiviteteve sipas preferencave të tyre.

Tek **qendra e leximit** fëmijët shikojnë dhe komentojnë libra, revista e figura ku shikojnë fëmijë të ndryshëm, fëmijë me ngjyrë, më aftësi të kufizuara e të tjera.

Në **qendrën e artit** edukatorja kishte përgatitur një karton të madh ku kishte vizatuar dy kontura të trupit të njeriut dhe kërkoi nga fëmijët që në fillim të mendojnë dhe të vijnë me një ide se si do t'i vizatojnë dhe modelojnë konturat me figura njëjërëzish.

Pasi që të gjithë fëmijët vizatojnë duart e tyre në fleta të vogla, tek **qendra e matematikës**, i grumbullojnë dhe i klasifikojnë ato sipas madhësisë dhe ngjyrave, si dhe i numërojnë ato.

Tek **qendra e familjes** fëmijët me kukulla me ngjyra improvizuan lojëra. aty është e vendosur edhe një kukull pa këmbë. edukatorja i udhëzon që ta përfshijnë në lojë duke pasur parasysh nevojat që ka kukulla.

Në fund të punës në qendra, fëmijët prezantuan punimet e tyre të cilat u vlerësuan nga të tjerët.

Pasdite edukatorët e të gjitha grupeve së bashku me fëmijet përgatitën disa ballona në të cilët kishin shkruar disa të drejta të fëmijëve dhe të ilustruara u vendosën në rrethojat e oborrit. Këto mesazhe për disa ditë rradhazi u lexuan nga prindërit së bashku me fëmijët.

Këndvështrimi i fëmijës/ prindit

Arona më tha: sot kam kaluar shumë mirë në kopsht sepse kemi mësuar për të drejtat tona dhe i kemi vizatuar ato në balona.

Kam mësuar dy fjalë në gjuhën turke.



## Reflektimi

Të pranishëm ishin 18 fëmijë prej të cilëve 10 djemë dhe 8 vajza, përfshirë këtu edhe një fëmijë me nevoja të veçanta.

Fëmijët mirëpritën nënën dhe fëmijën nga grupi tjetër. Po ashtu ishte rast i mirë që fëmijët të bashkëpunonin me fëmijët e grupeve tjera gjatë aktiviteteve në oborr.



# Kompetenca 4-2



# 1

## KOMPETENCA

## Planifikimi dhe Vlerësimi

### Parimi

4.2. Edukatori/Mësuesi planifikon mësimdhënien dhe të nxënit duke u bazuar mbi informacionin rreth kërkesave të fëmijëve dhe kërkesave kombëtare

### Treguesit

4.1.2.Edukatori/Mësuesi planifikon veprimtari që bazohen mbi nivelet dhe interesat zhvillimore të fëmijëve për të mundur që ata t'i përfitojnë kompetencat e rëndësishme

### Emri i aktivitetit

Si shkruhen librat

### Rezultatet e të nxënit

Rregullojnë qendrën e leximit  
Njoftohen me format e shkrimit të librave  
Modelojnë dhe punojnë libra të ndryshëm

### Materiali i nevojshëm

Letër e bardhë, letër me ngjyra, lapsa, ngjyra, gërshërë, penjë për lidhje etj.

### Ndërlidhja e kompetencave

Familja dhe komuniteti, ndërveprimi



## Faza I - Parapërgatitjet

Qendra e gjuhës dhe leximit, të cilat janë të vendosura në klasë, janë të ndërtuara dhe të përshtatshme që t'i shërbejnë sa më mirë edukimit dhe zhvillimit të fëmijëve, duke u mundësuar në këtë mënyrë për të biseduar dhe komunikuar në një mjedis të ngrohtë. Aty fëmijët njoftohen me shkronjat dhe kanë mundësi edhe t'i shkruajnë ato. Qendra u pajis me libra të llojllojshme si dhe me ulëse të buta ku fëmijët rehatshëm shfletojnë librat. Me ndihmën e prindërve këtë kënd e paturam me libra të ndryshëm.

Fëmijët vetë i vendosën librat në vendin e tyre dhe rregulluan qendrën duke bërë ndryshime. Ata vendosën edhe mobilet dhe raftet. Pasi përfundoi rregullimi dhe pajisja e qendrës me libra, dhe interesimi i fëmijëve u rrit, vendosëm të flasim për rëndësinë e librit dhe për atë se si krijohet ai. Për këtë kërkua që edhe prindërit të kontribuojnë.

Kështu disa prej tyre shprehën dëshirën për të qenë pjesë e vizitave duke e siguruar edhe transportin. Gjatë realizimit të këtyre aktiviteteve, planifikimimit tonë iu shtua një aktivitet që doli si interesim i vet fëmijëve, e që ishte krijimi i një libri.

### Realizimi i aktiviteteve për libra përmbajtje:

- Analiza e librit: kopertinat, titulli, autori, teksti, figurat dhe fotot
- Takimi me shkrimtarë për fëmijë
- Dallimi i librit nga revista, gazeta, albumi, kalendari
- Bashëpunimi me prindërit
- Vizita në bibliotekën e qytetit
- Vizita në shtypshkronjë
- Punimi i librit nga vetë fëmijët



**Pritja e fëmijëve:** ditën e filluam me pritjen e fëmijëve duke u përshëndetur me ta në takimin e mëngjesit. Zakonisht në fillim fëmijët përshëndesin njëri-tjetrin, pastaj plotësojmë kalendarin duke shënuar me saktësi ditën, datën, kohën, stinën, muajin dhe vitin. Pastaj bisedojmë në grup për librin dhe rëndësinë e tij. Kërkojmë që secili të ndajë me të tjerët mendimin për një libër që i ka pëlqyer. Kishim sjellë disa lloje të librave për të nxitur fëmijët të mendojnë. Librat kishin madhësi të ndryshme, disa prej tyre kishin ilustrime e disa jo, kishte poashtu libra të krijuara nga punimet e fëmijëve. Analizuam kopertinat dhe përmbajtjet dhe kështu bëmë së bashku edhe klasifikimet e librave sipas kriterëve të ndryshme.

Më pas së bashku bëmë plane për vizitat në bibliotekë si dhe shtypshkronjë për të parë për së afërmi se si punohet një libër. Kërkuam nga fëmijët të shkojnë në qendra dhe të analizojnë librat dhe revistat që kemi në klasë, se çfarë përmbajtje kanë, çfarë llojkoportinash, ngjyrash etj. Po ashtu kërkuam që fëmijët të sjellin librat e tyre të preferuar për të ndarë me të tjerët.

Ditën e tjetër e filluam me prezantimin e disa librave të preferuar nga fëmijët. Për shkak të kohës vendosëm, që çdo ditë të prezantohen nga 3 libra.

Me ndihmën e dy prindërve realizuan vizituam bibliotekën ku bibliotekarja u kërkoi fëmijëve të kenë kujdes, të mos bëjnë zhurmë, sepse do t'u pengonin të tjerëve të cilët ishin duke lexuar. Posa hymë brenda në objektin e bibliotekës aty pamë shumë veta duke lexuar në heshtje me përqendrim.

**Fëmijët vunë re librat e vendosur nëpër raftet, ata shikuan sallat, shumëllojshmërinë e librave të ndryshëm nga autorë të ndryshëm që i nxitin të bëjnë shumë pyetje si:**

- Kush i ka blerë gjithë këto libra?
- A rrinë lexuesit gjithë kohës duke lexuar këtu?
- Kush i shkruan librat?
- Pse ky libër e ka kopertinën e trashë?.



Fëmijë kishin mundësi të shfletonin disa libra, dhe t'i analizonin ato.

Në bibliotekë fëmijët morën shumë informacione nga bibliotekarja e cila pas sqarimeve të shumta, fare në fund u dha edhe një dhuratë të vogël si kujtim nga vizita së tyre në bibliotekë.

### Vizita në shtypshkronjë

Të nesërmen vizitua shtypshkronjën dhe kjo vizitë u la fëmijëve shumë mbresa. Ata përveç që e shtuan kuriozitetin që e kishin për bibliotekën, këtu kuptuan procesin e vërtetë të shtypjes së librit, panë shumë fleta të bardha të shkruara me shkronja dhe figura të ndryshme që dilnin nga makineritë e zhurmshe.

Një përfaqësues i shtypshkronjës na ndihmoi të kuptojmë procesin e shtypjes së faqeve të librit, por jo vetëm kaq, sepse ne shkuam gjithashtu edhe tek reparti i lidhjes së librit duke mësuar se libri paloset dhe lidhet me

qepje ose me tel. Këtu fëmijët patën rastin që vet të palosin libra dhe të provojnë lidhjen e tyre. Të gjithë patën dëshirë të përfshihen në këtë proces.

Pasi përfundua vizitat në shtypshkronjë fëmijët ishin ende të entuziazmuar me atë çfarë panë brenda.

Të nxitur nga këto vëzhgime, fëmijët duke u kthyer rrugës për në kopsht diskutonin dhe bënin plane se si vet mund të krijonin libra. Çfarë do të përgatisnin, cilat do të jenë ngjyrat që do të përdornin brenda figurave në libër, etj.

## Takimi me shkrimtarin për fëmijë

Dita me më shumë kureshtje për fëmijët ishte takimi me shkrimtarin që na erdhi për vizitë në kopsht. Ai ishte gjyshi i një fëmije në grupin tonë. Aty biseduan për shumë gjëra rreth librit. Me vëmendje dhe plot kureshtje ata shikonin e dëgjonin shkrimtarin duke kuptuar se ai si inspirohej të shkruajë.

Biseda ishte shumë interaktive, fëmijët bënë pyetje të ndryshme dhe merrnin mendime që lidheshin me librat. Në këtë mënyrë ata i plotësonin dhe konkretizonin njohuritë që kishin për përgatitjen e librit.

Në fund të vizitës gjyshi u shpërndau nga një libër dhe u tregoi një tregim të shkurtër të cilin fillimisht nuk e përfundoi, por kërkoi që fëmijët të japin mendimet për përfundimin.

Pas dëshirës së madhe të fëmijëve për të përgatitur një libër, mbledhëm materialin filluam të vizatojmë në lidhje me përmbajtjen e tregimit tëgjyshit shkrimtar në sekuenca të ndryshme. Pastaj i ngjyrosëm dhe i lidhëm në një libër të cilit në fund ia vumë edhe kopertinat. Ky libër pasuroi bibliotekën tonë në qendrën e leximit.

## Reflektimi

Këto aktivitete ishin shumë të rëndësishme për fëmijët e grupit, ata pasuruan fjalorin, su dherritën interesimin për librin. Vizitat shtuan kureshtjen e fëmijëve për libra, si dhe i nxitën ata të krijojnë libra. Tema e këtyre ditëve po ashtu nxiti fëmijët të jenë më të kujdesshëm ndaj librave që kemi në klasë.

### **FVështirësitë dhe sfidat:**

Gjatë vizitës në bibliotekë ishte pak vështirë të mbanim qetësi sepse fëmijët ishin kurioz dhe kishin nevojë të shtronin pyetje. Ishin prindërit ata që na ndihmuan që ta realizojmë këtë me sukses.



# 2

## KOMPETENCA

## Planifikimi dhe Vlerësimi

### Parimi

4.2 Edukatori/Mësuesi planifikon mësimdhënien dhe të nxënit duke u bazuar mbi informacionin rreth kërkesave të fëmijëve dhe kërkesave kombëtare

### Treguesit

4.2.2 Planet dhe veprimet e edukatorit/mësuesit janë fleksibël për të pranuar dhe integruar rrethanat e ndryshme, nevojat dhe interesimet e fëmijëve.

### Aktivitetet/ veprimtaritë edukative

Kujdesi për kafshët

### Rezultatet e të nxënit

Informimi rreth mënyrës se si të kujdesemi për kafshët si dhe dobisë që kemi nga kafshët  
Krijimi i shprehive të punës ndaj kafshëve, zhvillimi i shkathtësive kreative

### Materiali i nevojshëm

Materialet didaktike: fletë hamer, lapsa, letër, ngjyra ngjites etj.  
Merialet recikluuese: gazetë, kese, penjë të ndryshem etj.  
Fotoaparati, Kamerë, Transporti (mini bus), Literaturë etj.

### Ndërlidhja e kompetencave

Ndërveprimi dhe Strategjitë e mësimdhënies,



## Faza I: Parapërgatitja

Interesimi i vazhdueshëm i fëmijëve për kafshët shprehet në diskutimet e përditshme të fëmijëve për kafshët, shpezët e insektet. Po ashtu nevoja për të mbajtur zgjuar kureshtjen dhe koncentrimin e fëmijëve në kohëzgjatje të temave, ishte përzgjedhja e një tematike që ka të bëjë me kafshët. Kjo shihej si mundësi që fëmijët të rrisin përqëndrimin në angazhimet që ata kanë gjatë lojës, si: të kuptuarit më të mirë gjatë analizimit të një fushe apo dukurie, mundësia për të përfshirë elemente reflektimi, diskutime, e shumë elemente tjera. Kjo ishte arsyeja që menduam të realizojmë veprimtari edukative për kafshët.

Gjatë prezantimit të idesë dhe planeve se çka mund të bëjmë përmes këtyre aktiviteve, vërehej dëshira dhe gadishmëria e fëmijëve për informim për mënyrën e kujdesit ndaj kafshëve. Po ashtu përzgjedhja e e aktiviteve është bërë së bashku me fëmijët duke i përshtatur me grup-moshën e tyre dhe duke u bazuar në nevojat dhe kërkesat e fëmijëve. Qëllimi i gjithë projektit ishte formimi i shprehive të punës për kujdes ndaj kafshëve si dhe pasurimi i njohurive për jetën, llojet dhe dobitë që kemi nga kafshët. Përpunimi i poezive dhe këngëve për kafshët, përgatitja e një këndi të improvizuar me kafshë të punuara nga fëmijët si dhe prezantimi i një pjese teatrale me temë “Kafshët”. Kryesisht aktivitetet do të kenë ndërlidhje hapësinore kopsht-vizita jashtë kopshtit.

## Faza II: Realizimi

Aktivitetet fillestare ngërthyen paranjohuritë, parainformatat e fëmijëve për kujdesin ndaj kafshëve përmes aktiviteve: përshkrim ngjarjesh individuale duke nxitur pyetjet në takimin e mëngjesit, si: çka dijmë për kafshët, si mund të kujdesemi për to, ku jetojnë shumica e kafshëve, cilat kafshë mund të jetojnë bashkë me njerëzit, a ka dikush nga fëmijët që ka kafshë në shtëpi?



Takimi i mëngjesit u përmbyll duke marrë dhe përpunuar komentet e fëmijëve për librat rreth kafshëve si dhe vendosja e tyre ne poster për t'i ekspozuar në murin e punimeve.

Aktivitetet pastaj u përqendruan në qendra të punës ku disa nga fëmijët filluan të selektojnë dhe analizojnë librat që gjendeshin në këndin e librave në dhomë. Udhëzimet për këtë qendër të punës ishin që të vëzhgojnë dhe dallojnë librat me ilustrime me kafshë, me shpezë dhe me insekte. Pas kësaj, fëmijët vazhduan me vendosjen e librave në dollap sipas preferencave të tyre dhe ne fund zgjodhën librin më të pëlqyer për ta lexuar edukatorja.

Qendra e artit më parë është pasuruar me materiale të ndryshme recikluese të sjella nga prindërit të cilët janë informuar për këto aktivitete në takime të përbashkëta. Puna në qendrën e artit dhe pasurimi i saj më material nga më të ndryshmet u mundëson fëmijëve të bashkëpunojnë mes vete, të ndihmojnë njëri-tjetrin si dhe të inspirohen nga kreativiteti që del nga secili fëmijë. Materialet recikluese tani përdoren nga fëmijët për të vizatuar, modeluar dhe dekoruar punimet e tyre me figura të kafshëve dhe shpezëve të ndryshme, si: punimi i garderobës, kapelave, punimi i mbulojës së fëmijëve që do ta përdorin gjatë vizitave në fermë dhe punëve që do t'i kryjnë gjatë kujdesit ndaj kafshëve. Të gjitha këto punime u modeluan me materiale reciklues si: kese, letër, penjë etj. Po ashtu edhe shtalla dhe shtëpia e kafshëve e cila u vendos në një kënd të dhomës për ta përdorur në ditët në vazhdim.



Qendra e blloqeve me elementet e saj u shfrytëzua nga fëmijët për të ndërtuar hapësirat ku jetojnë kafshët si dhe rrugë të ndryshme që tregonin mënyrën se si të arrijmë tek secila kafshëtë cilat tashmë i kishim në kopsht. Atou vendosën të gjitha brenda kasollave dhe në oborr në vendet e improvizuara nga fëmijët në këtë qendër.

Njëra nga qendrat u përdor për lojëra simbolike të cilat fëmijët i realizuan me shumë të qeshura, duke imituar zëra dhe tinguj të kafshëve, vrapimet, ecjet e tyre, etj.

Aktivitetet e ditëve tjera ishin të fokusuar në disa vizita, si në fermën e kuajve në Vushtrri, ku fëmi-



jët patën rast të bashkëbisedojnë me kujdestaërt e kuajve, të cilët treguan për mënyrën e jetësës së tyre, ushqimin, kujdesin që u nevoitet, si dhe shumë pyetje tjera që fëmijët i bënin me shumë kureshtje. Po ashtu fëmijët patën rastin të përjetojnë ndjesinë e kalërimit dhe të shohin akrobacione të kuajve.



Vizita e radhës ishte në minifermën e Shkollës së Bujqësisë në Prishtinë. Fëmijët vrojtuan mënyrën e ushqimit të kafshëve si: lopa, delja, dhia, si dhe demonstrimin e mjeljes së lopës.

Në vizitën e fermës së dhive në lagjen Sofali në Prishtinë, u krijua situatë spontane me breshkën të cilën e takuam rrugës për në fermë. Vazhduam me shetitje në parkun e Taukbashqes për relaksim dhe argëtim të fëmijëve.

Vizita në parkun “Te Ariu” në Prishtinë u realizua me qëllim që të shohim sa më shumë kafshë të ndryshme në një vend dhe të dallojmë kafshët e buta dhe të egra, mënyrën e jetësës, e të ushqyerit si dhe , kujdesin ndaj tyre, etj.

Ndërsa vizita e fundit për këtë qëllim ishte në fabrikën e qumshtit “Bylmeti”, ku fëmijët patën rastin të shohin për së afërmi produktet që vijnë nga kafshët dhe përpunohen në këtë fabrikë, si: demonstrimi i përpunimit të qumshtit, ambalazhimi i jogurtit, kosit dhe produkteve tjera.







### Faza III: Reflektimi

Realizimi i të gjitha aktiviteteve në kopsht dhe në vizita të ndryshme ka zgjuar një interesim të jashtëzakonshëm tek secili fëmijë. Kjo mënyrë e punës nxiti secilin fëmijë të jetë aktiv, të japë ide, të propozojë mënyra se si të vazhdojmë tutje për të kuptuar më shumë për kafshët. Dëshira dhe entuziazmi i fëmijëve rritej çdo ditë dhe kjo shihej kur në mëngjes vinin me rrëfime për bisedat që kanë zhvilluar me prindërit në shtëpi si dhe idetë të cilat i shprehnin për vizita dhe aktivitete që mund t'i zhvillojmë në kopsht. Po ashtu prindërit përmes këtyre aktiviteteve u angazhuan më shumë në komunikim dhe marrje të informatave si dhe shprehnin gadishmërinë për të na përkrahur me materiale apo shpenzime tjera rreth transportit.

### Sfidat dhe vështirësitë

Realizimi i aktiviteteve në natyrë dhe numri i mysafirëve të pranishëm, sollën vështirësi në organizimin e kohës, materialeve dhe përgatitjet rreth fëmijëve, duke pasur parasysh nevojat, kërkesat në moshën e tyre. Në këso aktivitete kërkohet të angazhohet i gjithë stafi dhe të planifikohet çdo detaj, në mënyrë që të gjitha aktivitetet të realizohen sipas planit.



# Kompetenca 5-5



# 1

KOMPETENCA	SRATEGJITË E MËSIMDHËNIES
Parimi	5.1. Edukatori/mësuesi zbaton një shumëllojshmëri strategjish mësimore që i përfshijnë aktivisht fëmijët për të zhvilluar dijet, aftësitë dhe predispozitat, siç përcaktohen nga kurrikula mësimore si dhe të promovohet të nxënit gjatë gjithë jetës
Treguesit	5.1.3 Edukatori/mësuesi përdorë strategji për të promovuar aftësitë e të menduarit të nivelit më të lartë dhe të zgjidhjes së problemeve
Aktivitetet/veprimtaritë edukative	Ndryshimet në natyrë pas shiut
Rezultatet e të nxënit	Diskutojnë dhe tregojnë për ndryshimet që ndodhin në natyrë pas dukurive atmosferike Hulumtojnë dhe analizojnë elementet nga natyra, si barin, gjethet, drunjte, dheun e të tjera Bashkëveprojnë me të rriturit dhe bashkëmoshatarët Vëzhgojnë dhe demonstrojnë procesin e shiut
Materiali i nevojshëm	Llupë, tenxhere me kapak dhe ujë, pllakë e nxehtë, letër
Ndërlidhja e kompetencave	Ndërveprimi, planifikimi dhe vlerësimi, mjedisi mesimor



## Përgaditjet

Për shkak se disa ditë rradhazi binte shi, edukatorët vendosën që një ditë gjatë javës të organizojnë aktivitete në oborr, ku fëmijët mund të analizojnë ndryshimet të cilat ndodhin në natyrë. Ndërkohë edukatorët përgatitën disa letra në formë të pikave të shiut të cilat do të përdoren gjatë punës në qendra të aktiviteteve.

## Përshkrimi i realizimit të aktivitetit

Pasi atë ditë kishte ra shi edukatorja pas mëngjesit kërkoi nga fëmijët që të mbathin këpucët dhe të dalin që ta eksplorojmë natyrën pas shiut. Ishte qershor dhe nuk kishim nevojë për xhaketa. Kur dolëm në oborr, vërejtëm se në shtegun e betonit kishte ende pellgje me ujë, ku fëmijët kishin dëshirë të kërcenin dhe të spërkateshin. Pas një kohe sa fëmijët luajtën me ujë, edukatorja i ftoi dhe u kërkoi që të ndaheshin në grupe nga 3-4 veta dhe të vëzhgojnë oborrin pas shiut. Fëmijët vetë u ndanë në grupe sipas preferencave dhe u shpërndanë në pjesë të ndryshme të oborrit. Në edukatorët qëndronim gjithnjë pas fëmijëve dhe kërkonim që të gjenim ndryshimet që ka bërë shiu. Deri sa fëmijët ishin duke hulumtuar, dielli doli dhe shumë shpejt filloi të nxehej moti. Pas rreth 25 min, njëra edukatore i ftoi fëmijët të bashkohen të gjithë. Nuk ishte lehtë të mblidheshin të gjithë, për shkak se kishte fëmijë që ende hulumtonin. Sapo erdhën të gjithë, edukatorja u tregoi për ylberin që ishte në qiell dhe u shpjegoi se pse kishte dalë. Fëmijët kishin pyetje rreth ngjyrave të ylberit, të cilat edukatorja u shpjegoi se krijohen nga thyerja e dritës nga rrezet e diellit pas shiut. Pastaj të gjitha grupet treguan çka kanë gjetur në oborr pas shiut.

Grupi i parë tha se në fund të oborrit kishte baltë dhe ishte një vend me shumë ujë. Aty afër kishin pa dy skrraja të cilat fillimisht nga fëmijët u quajtën krimba me ç'rast edukatorja u tregoi për dallimin mes skrrajës dhe krimbit. Me kërkesën e fëmijëve i gjithë grupi u afrua dhe panë skrrajat dhe i hulumtuan ato. Në një gotë vendosëm pakëz dhe, dy skrraja për të analizuar më vonë. Po ashu biseduam se çka i bën skrraja tokës dhe si i ndihmon që ajo të përpunohet.

Grupi i dytë kishte analizuar gjethet se si janë mbushur me ujë se si disa prej tyre ishin shkëputur dhe kishin rënë në tokë. Ky grup po ashtu kishte sjellë edhe dy kërmij të cilët zgjuan kureshtjen tek të gjithë fëmijët. Grupi i tretë po ashtu kishte analizuar tokën e lagësht, aty ku kishte ra shi si dhe disa lule nën një strehë që nuk ishin lagur. Kështu vazhduan të gjitha grupet deri sa një fëmijë vërejtë se në vendin ku po qëndronim nuk kishte më pellgje uji. Aty filluam diskutimin se ku shkuan ato, a i ka thithur toka apo janë avulluar nga nxehtësia e diellit.



Pas kësaj u kthym në klasë, ku në grup të përbashkët me një pllakë të nxehtë dhe një tenxhere demonstruam krijimin e shiut në kapakun e tenxheres. Fëmijët kishin shumë pyetje si: a ka kapak në qiell, sa pika ka shiu, nga vjen shiu e pyetje të tjera. Kishte edhe komente interesante si: nëse nxehet kaq shumë shiu do te avullojnë të gjithë lumenjtë dhe detet.

Pas këtij demonstrimi fëmijët shpërndahen në qendra të aktiviteteve.

Në qendrën e matematikës me anë të letrave me fomra sikur pika të shiut, të përgatitura paraprakisht nga edukatorja, klasifikojnë pikat sipas ngjyrave, madhësive dhe i vendosin në pozicione të ndryshme.

Në qendrën e artit, vizatojnë përjetimet nga hulumtimi në oborr. Në qendrën e gjuhës, provojnë të shkruajnë shkronjat e fjalës SHIU, në letra me ngjyra në forma të pikave të shiut, ndërsa në qendrën e shkencës, analizojnë kërmijt dhe skrrajat e gjetura në oborr. Përdorin Ilupën për të analizuar skrrajat, si dhe provojnë për t'i ushqyer me disa gjethe.

#### Metodologjia e punës:

- Hulumtim në grupe të vogla
- Analizë e të gjeturave
- Diskutim dhe demonstrim

#### Këndvështrimi i fëmijës/ prindit

E kam prek dheun dhe kërmillin dhe me ka pëlqyer edhe pse mami gjithmonë me thotë mos u përlyej.



## Reflektimi

Aktivitetet ishin shumë të përshtatshme për fëmijët. U vërejt se u kënaqën duke hulumtuar. Kishin mundësi që në grupe të analizonin dhe diskutonin si dhe mësuuan shumë nga njëri tjetri. Për shkak të prezencës së gjallesave, qendra e shkencës ishte më interesante se ditëve tjera dhe të gjithë shprehnin dëshirë të qëndronin më gjatë në te. Gjatë tërë kohës fëmijët ishin shumë aktiv dhe të disponuar.

### Alternativa të tjera për zhvillim të aktivitetit:

Për shkak se gjatë aktivitetit në oborr përmendëm edhe ylberin, do të ishte mirë që në klasë këtë ditë apo ndonjë ditë tjetër të demonstrojmë procesin e krijimit të tij me një llupë.

### Vështirësitë/sfidat:

Si sfidë gjatë realizimit të këtij aktiviteti ishte kujdesi i shtuar që duhej të kishim gjatë demonstrimit të procesit të shiut me ujë të vluar dhe përdorimit të pllakës së nxehtë.

# 2

## FORMAT E PREZANTIMIT TË PRAKTIKAVE TË MIRA

KOMPETENCA	SRATEGJITË E MËSIMDHËNIES
Parimi	5.1. Edukatori/mësuesi zbaton një shumëllojshmëri strategjish mësimore që i përfshijnë aktivisht fëmijët për të zhvilluar dijet, aftësitë dhe predispozitat, siç përcaktohen nga kurrikula mësimore si dhe të promovojë të nxënëit gjatë gjithë jetës
Treguesit	5.1.3 Edukatori/mësuesi përdorë strategji për të promovuar aftësitë e të menduarit të nivelit më të lartë dhe të zgjidhjes së problemeve
Aktivitetet/veprimtaritë edukative	Libri im
Rezultatet e të nxënëit	Diskutojnë dhe flasin rreth librave, përrallave e ilustrimeve, vlerësojnë rëndësinë e librave, modelojnë libra me materiale recikluese
Materiali i nevojshëm	Libra, revista, përralla, ilustrime, materiale të ndryshme për kuiz etj.
Ndërlidhja e kompetencave	Mjedisi mësimor, Ndërveprimi



## Përgaditjet

Muaji prill njihet si muaji i librit prandaj edukatorët e grupit planifikuan që ky projekt të jetë i dedikuar vetëm për librin. Prindërit ishin bashkëpunëtorë aktiv në realizim të këtij projekti. Në javën e parë të muajit prill organizohet panairi i librit në Prishtinë dhe në këtë rast të dy edukatorët, me leje të prindërve kanë organizuar vizitën në panair. Gjatë vizitës, fëmijët përveç se janë njoftuar me tituj të ndryshëm të librave, ata edhe janë takuar me botues, shkrimtarë e poetë si dhe është planifikuar të blihen disa libra, bashkë me fëmijët, për të pasuruar bibliotekën e librave në dhomë.

Këto libra janë ekspozuar pastaj në aktivitetin e radhës në oborr të kopshtit që edhe fëmijët e grupeve tjera të kenë mundësi të shohin, të shfletojnë dhe të inspirohen nga librat e ndryshëm. Në përfundim të projektit, është organizuar vizitë në bibliotekën e qytetit, si dhe është ftuar për vizitë një shkrimtar në kopsht. Projektin e dedikuar për librin e përmbyllëm me Kuizin e Diturisë, të përgatitur nga edukatorët dhe fëmijët.

## Përshkrimi i realizimit të aktivitetit

Gjatë takimit të mëngjesit është bashkëbiseduar me fëmijë për aktivitetet që do të zhvillohen me temën e re. Fillimisht, edukatorët nxitën fëmijët të diskutojnë për librat, përrallat dhe tregimet që ata i pëlqejnë, të shprehen pse i pëlqejnë, të tregojnë se cilët janë personazhet e pëlqyera, cila ngjarje zhvillohet brenda një tregimi që ata e njohin, e shumë pyetje tjera që tek fëmijët nxitën të menduarit.

Meqenëse shumë libra që u përmenden nga fëmijët, ishin kryesisht me ilustrime filluam të shohim se cilët libra janë në këndin e librave në dhomë.

Fëmijët me shumë entuziazëm filluan të marrin një nga një librat me përralla, tregime, nga këndi dhe t'i vendosin në mes të rrethit në takim. Fëmijët veçse janë njoftuar me këndin e leximit kështu që gjatë takimit të mëngjesit nxiten të flasin për librin. Projekti filloi me vizitën në panairin e librit, aktivitet që kishte për qëllim familjarizimin e fëmijëve me librin dhe njohjen e konceptit të panairit të librit. Në përzgjedhje të librave u morën parasysh dëshirat e fëmijëve me ç'rast së bashku me edukatorët blenë librat e dëshiruar, duke begatuar kështu koleksionin e librave në kopsht.

Librat e blerë gjatë panairit të librit, janë sjellë në kopsht dhe është krijuar ekspozitë e librit në oborrin e kopshtit. Grupi i fëmijëve 4-6 vjeç arritën që të shikojnë më ngadalë edhe për së afërmi

librat e blerë dhe t'i vendosin pastaj ato në këndin e librave brenda në kopsht. Përgjatë muajit të projektit edukatorja në vazhdimësi lexoi fragmente nga këto libra

Vizita e radhës gjatë këtij projekti ishte në bibliotekë. Qëllimi i vizitës ishte që fëmijët të njihen me bibliotekën, se sa shumë nxënës e studentë lexojnë në bibliotekë, sa qetësi duhet për koncentrim gjatë leximit etj. Ata u njoftuan me stafin e bibliotekës dhe shikuan për së afërmi librat dhe sallat e leximit. U informuan për rëndësinë e librit, si duhet të kujdesen për librin dhe se sa shumë dijeni mund të fitojnë gjatë leximit.

Në përfundim të projektit, edukatoret kanë organizuar një garë diturie (kuiz) ku fëmijët treguan njohuritë dhe shkathtësitë e fituara gjatë tërë muajit. Fëmijët janë ndarë në katër grupe që nga fillimi i projektit dhe gjatë gjithë kohës kanë bashkëpunuar mes vete dhe me edukatore për të mësuar përmbajtjen e librave. Kjo bëhej përmes figurave apo leximit të tyre nga edukatoret dhe prindërit aktiv të projektit. Gjatë kuizit, fëmijët u argëtuan duke garuar, luajtur, vlerësuar diturinë e fituar gjatë 4 javëve si dhe u shoqëruan edhe më tepër me punën bashkëpunuese të ekipeve.

### **Këndëvështrimi i fëmijës/ prindit:**

Fëmijët u kënaqën pafund me këtë projekt sepse arritën të vlerësojnë rëndësinë e librit, të përfitojnë dituri nga vizitat dhe të jenë pjesë e organizimeve brenda kopshtit në lidhje me librin. Tashmë libri simbolizon dashuri dhe vlerë për secilin prej tyre.

## **Reflektimi**

Fëmijët janë njoftuar me librin dhe rëndësinë e tij duke vizituar panairin dhe bibliotekën si dhe duke qenë pjesë e garës së diturisë së organizuar në kopsht. Ata arritën ta duan librin më shumë dhe ta shohin librin si mjet për të fituar më shumë dituri. Nga çdo faqe e librit u fituan njohje të reja për botën dhe realitetin si dhe u zhvillua imagjinata. Gjatë vizitës në panair dhe bibliotekën e qytetit, fëmijët u kënaqën pa masë sepse u inspiruan nga të gjithë pjesëmarrësit libërdashës. Kontribut të veçantë dha shkrimtari i cili u mundua të përcjellë porosi të çmuara për dashurinë ndaj librit. Shumica e fëmijëve të grupit morën pjesë në këtë projekt të cilin e mirëpritën edhe prindërit.



# 3

## PRAKTIKË E MIRË

KOMPETENCA	SRATEGJITË E MËSIMDHËNIES
Parimi	5.3 Mësuesi /edukatori harton veprimtari duke marrë parasysh përvojat dhe kompetencat e fëmijëve në mbështetje dhe zgjerim të mëtejshëm të zhvillimit dhe të të mësuarit të tyre.
Treguesit	<p>5.3.2 Edukatori/mësuesi ofron për fëmijët një numër të mjaftueshëm dhe efektiv të skelave sipas programit dhe përvojave të tyre.</p> <p>5.3.4 Edukatori /mësuesi integron përvojat e të mësuarit, në mënyrë që fëmijët të kuptojnë marrëdhënien midis koncepteve të të mësuarit dhe përvojave të përditshme, si dhe mundësinë e zbatimit të tyre në situata reale.</p>
Aktivitetet/veprimtaritë edukative	Luajmë me ngjyrat
Rezultatet e të nxënit	<p>Shfaqin emocionet në gjuhën e ngjyrave.</p> <p>Interpretojnë realitetin në vizatime dhe dramatizime.</p> <p>Vëzhgojnë dhe shprehin emocionet me fjalë.</p> <p>Eksplorojnë ngjyrat përmes prekjes, formës dhe gjendjes.</p> <p>Dallojnë ngjyrat kryesore dhe nuansat e tyre.</p> <p>Manipulojnë me ngjyra në situata të ndryshme.</p> <p>Zhvillojnë sensin estetik në përdorimin e ngjyrave dhe përcjellin mesazhe me ngjyrat.</p>
Materiali i nevojshëm	Ngjyra të ndryshme, ngjyra uji, brusha, ujë, paleta.
Ndërlidhja e kompetencave	Ndërveprimi, Planifikimi dhe vlerësimi



## Parapërgatitjet

Dëshira e fëmijëve për të eksperimentuar me ngjyrat është e madhe. Të gjithë fëmijët dëshirojnë t'i prekin ato me dorë, dhe të zbulojnë mundësitë e ndryshme që ofrojnë ato. Ata janë kureshtarë për mënyrat se si përdoren, angazhohen të sjellin vizatimet e para me ngjyra. Dhe jo vetëm kaq, ky aktivitet shkon me tej i kthen ngjyrat në lojën më të dashur për fëmijët.

Edukatorët e orientuan veprimtarinë në disa etapa: në veprimtari edukative, fokusimin e vëmendjes së fëmijës mbi elemente të një ngjyre kryesore (e verdhë, e kuqe, e kaltër). Më pas kërkuan të dallojnë diferencat e ngjyrave, të përcaktojnë nuansat e tyre, përdorimin e skemës gjurmuese, përzierjen e ngjyrave, shtypjen, lidhjen e ngjyrave bazë si: e kuqe, e verdhë e kaltër.

Edukatorët diskutuan dhe përcaktuan teknikat e punës me ngjyra të cilat do të përdoren si: vizatimi, shtypja me sfunjjer dhe objekte të ndryshme, gishtat dhe duart, qese dhe plasmas, si dhe peneli dhe furça. Është e rëndësishme të potencohet se është mirë të përdoren materiale të shumëllojshme dhe në mënyra të ndryshme.

Megjithëse projekti “Luajmë me ngjyrat” duket sikur fokusohet te qendra e artit, edukatorët kërkuan lojëra dhe tregime që lidhen me botën e ngjyrave.

Qëllimi i kësaj veprimtarie mësimore kërkon të nxisë zhvillimin e aftësive njohëse dhe shprehëse, si: vrojtimi, vëmendja, kujtesa, imagjinata, të menduarit, të folurit. Po ashtu ndërtimi i pyetjeve është një prej elementeve, të cilat edukatorët do të kultivojnë te fëmijët me mjaft kujdes. Meqënëse në projekt do të përfshihen të gjitha grupmoshat, është e rëndësishme që të diferencohen aktivitetet.

Projekti u prezantua para prindërve, jo vetëm për t'u njohur si projekt, por edhe për t'i bërë partnerë në realizimin e tij. Prindërve iu kërkua që nëse ndonjëri nga ata ka njohuri dhe përgatitje në art, mund të ndërtojë skica për fëmijët ose së bashku mund të organizohen biseda në një studio ose atelje me prindër dhe fëmijë.

## Përshkrimi i realizimit të aktivitetit

Për grupin e fëmijëve 3/4 vjeç, eksplorimin e ngjyrës do ta zhvillojmë nëpërmjet prekjes, formës dhe lëndës. Me rëndësi është koordinimi sy-dorë dhe njëkohësisht aplikimi i rregullave gjatë lojës me ngjyra për fëmijët, si dhe konceptimi i ngjyrës në një situatë konkrete.



Takimi i mëngjesit filloi me bisedë dhe diskutime rreth ngjyrave, meqenëse rezultati i parë që edukatorët e kanë vendosur është njohja dhe familjarizimi me ngjyrat bazë: **e kuqe, e verdhë, e kaltër**, edukatorja e orientoi bisedën rreth veshjeve duke bërë pyetje dhe komente:

Fëmijë të dashur, ju, sot, paskeni sjellë në kopsht gjithë ngjyrat e pranverës.

Pranvera është stina që vjen me shumë ngjyra. Fushat mbushen me bar të gjelbër dhe me lule shumëngjyrëshe. A më tregon dikush nga ju a kanë çelur lulet e para? Po pema përpara kopshtit, a ka lulëzuar?

Fëmijët japin përgjigje të thjeshta dhe diskutojnë për ngjyrat që shohin në natyrë. Edukatorja vazhdoi me komentet për ngjyrat që kanë veshjet e fëmijëve.

Bora paska veshur sot një bluzë me ngjyrë të kuqe fëmijë. A më thoni, kush tjetër ka bluzën me ngjyrë të kuqe?

Fëmijët fillojnë dhe krahasojnë bluzat dhe nga përgjigjet jo të gjithë dallojnë ngjyrat, ata njohin të bardhën, të kuqen, të zezën ose ngjyrën e errët, si thonë ata.

**Aktivitetet rreth njohjes dhe dallimit të ngjyrave vazhdojnë në qendrat e aktiviteteve. Kështu në qendrën e artit në tavolinë edukatorja ka vendosur kuba me tre ngjyrat bazë. Ajo fillon të bëjë krahasimin duke thënë:**

- Ani ka bluzë të kuqe si Bora dhe si kubi i kuq,
- Jola ka veshur bluzë ngjyrë blu, si Sokoli. Dhe unë kam një kub ngjyrë blu.
- Kemi edhe një kub tjetër me ngjyrë të verdhë. A ka veshur dikush bluzë me ngjyrën si kubi mbi tavolinë?

Aktivitetet vazhdojnë me lojëra motorike, ku fëmijët zhvendosen në mjedisin e lojës. Ata ndahen në tri grupe me ndihmën e edukatores. Fëmijët formojnë tre rrathë dhe brenda secilit prej tyre vendosim një kub. Atëherë fillojnë të luajmë me kubat.



### Shpjegohen rregullat e lojës dhe pororsiten fëmijët që kur të hedhin kubin të thonë:

- Prite kubin tim me ngjyrën të kuqe!
- Prite kubin tim me ngjyrën të verdhë!,
- Prite kubin tim me ngjyrën blu!.

Loja vazhdoi rreth 10 minuta. Fëmijët ishin të gëzuar. Ata e përceptuan ngjyrën konkretisht, duke e prekur dhe luajtur. Një prej aftësive, që fëmijët e fitojnë duke ndërvepruar me edukatoren dhe me njëri –tjetrin, është të respektojnë njeri- tjetrin duke pritur rradhën.

Aktivitetet në qendrën e artit zhvillohen pasi që fëmijët zhvendosen në ateljen e grupit. Kjo veprimtari zgjat rreth 20 minuta dhe në të përfshihen të gjithë fëmijët. Edukatorja i ndanë në grupe, duke u thënë ngadalë që ata duhet të zbatojnë rregullat në atelje, duke qenë e vëmendshme edhe për dëshirat e fëmijëve.

Ateljeja shërben për të nxitur dëshirën për artin, estetikën, por me rëndësi është zhvillimi i motorikës fine, realizimi i detyrave si: përdorimi i furçës, penelit, lapsit, sfungjerit. Mund të përdoren edhe materiale të ricklueshme: si tela të butë, lesh, copëza stofi a beze, çdo material që do t'i shërbente fëmijës për të zhvilluar motorrikën fine, që veçanërisht për këtë moshë, ka peshë të veçantë.

Në ditën në vazhdim, vazhdojnë aktivitetet me temën: **“Manipulojmë me ngjyra”**. Fëmijët kanë veshur përparëset e punës dhe ndahen në atelje. Si fillim, i pyesim fëmijët për dëshirën, pastaj i ndajmë në grupe duke u thënë që tavolinat do të ndryshohen në mnëyrë që të gjithë fëmijët të kalojnë kohën në atelje. Nuk është e thjeshtë t'i bindësh, por me kohë ata kanë vendosur rregullin e grupit. Ata janë të lirë të manipulojnë në çdo tavolinë, por kërkohet që të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin. Edukatorja qëndron pranë për t'i mbështetur kur ata kanë nevojë apo nëse ndodh të hasin në mosmarrëveshje. Në tavolinat e punës janë vendosur materiale të ndryshme. Fëmijët kanë përpara ngjyra të forta (ose bazë) të prezantuara në gjendje të ndryshme në atelje, të lëngëta, të forta, të buta, si dhe letra të copëtuara.

Ata manipulojmë me gishta, timbrojnë me gishta dhe pëllëmbë, timbrojnë me sfungjer, përdorin furçën dhe penelin në kartonët e vendosur. Edukatorja qëndron pranë dhe orienton e udhëzon që fëmijët të mos përziejnë ngjyrat.

Në fund, ata bëjnë një pikturë, jo fort të rregullt, por interesante dhe shumë të bukur.

Aktiviteti tjetër organizohet në një kënd të qetë në dhomë. Me këtë rast nuk është e lehtë që ata të jenë të vëmendshëm, prandaj edukatorja ka zgjedhur një përrallë që është e thjeshtë, e shkurtër, por në fabulën e saj përmenden disa herë elementet e ngjyrave bazë. Pra, në këtë mënyrë provojmë të nxisim interesin për ngjyrat dhe të ngjallim kureshtjen për to. Edukatorja tregon përrallën "Historia e tri fluturave dhe tre trendafilave". Gjatë rrëfimit të përrallës, fëmijët janë të ulur në këndin e qetë. Edukatorja përdor teknika të ndryshme gjatë leximit, ndryshon timbrin e zërit, bën pauzat për tërheqjen e vëmendjes, si dhe teknikën e mbajtjes së librit. Ajo e fragmenton përrallën, ndërpret leximin duke u treguar ilustrimin e përrallës. Përralla shoqërohet me vizatime, postera të përgatitur më parë nga edukatorja.

Në këtë fazë të përrallës nuk kërkohen komente nga fëmijët. Ato do të kërkohen në një fazë tjetër, pasi ata do ta rikthejnë leximin e përrallës duke komentuar dhe analizuar përrallën.

Aktivitetet në vazhdim kanë për qëllim të kuptojmë në mënyrë globale ngjyrat, të identifikojmë në një grup ngjyrën e caktuar, të ndajnë nga një grup më shumë se tri ngjyra. Aktiviteti inicohet me lojëra logjike, si ai « Luajmë me topat e ngjyrosur ». Fëmijët janë ndarë nga 6 në grupe. Secili prej tyre ka nga një top të vogël me ngjyrë dhe në mjediset e klasës janë vendosur shporta me tri ngjyrat bazë. Organizatori i lojës thërret "Topat e kuq në shtëpinë e tyre!". Fëmijët duhet të hedhin topin brenda në shportë. Në fund shportat krahasohen me ndihmën e edukatores. Shportat ku ka më shumë topa dhe ato ku ka më pak dhe në këtë mënyrë fëmijët njohin konceptin shumë dhe pak, duke realizuar krahasimin.

**Luajmë me tubat plastikë.** Edukatorja ka përgatitur mjedisin mësimor, në dhomë ose në palestër ku janë vendosur tuba plastikë të butë që kanë formën e një tuneli. Tubat ose rrathët janë në tri ngjyra. Fëmijët rreshtohen dhe me ndihmën e edukatores do të zvarriten duke ecur këmba-doras. Kjo lojë mund të organizohet në momente të ndryshme të ditës, mund të jetë edhe një lojë mëngjesi për të ndryshuar atmosferën në kopsht.

**Metodologjia e punës:** përvojat e drejtëpëdrejta, lojërat didaktike alternative, ndërveprimi, teknika e kolazhit si dhe skema gjurmuese.



## Reflektimi

Krijimi i mjedisit të të nxënit për një grupmoshë të veçantë, kërkon strategji të mësimdhënies që të jenë të aplikueshme për këtë grupmoshë. Edukatorët treguan që njohja e ngjyrave është një prej koncepteve të vështira, por edhe të rëndësishme për procesin e njohjes të fëmijët. Inicimi i aktiviteteve do strategji që përfshijnë fëmijët. Nuk është e lehtë t'i organizosh, ato here-herë deviojnë, prandaj ne qënë planifikim përcaktuar strategjinë, pyetjet, zgjedhëm dhe përshtatëm lojërat, simbolikën, përzgjedhëm përfaqsimin ndaj të nxënit dhe aftësitë e ndryshme që fëmijët do të fitonin. Kjo veprimtari është disaditore dhe edukatorja mund të zhvillojë disa veprimtari të ngjashme, por në situatë ndryshe.

Koncepti “Lojërat e motorikës së madhe” është shumë atraktive për fëmijët e kësaj grupmoshe. Të mësohet duke luajtur ose duke bërë, është një prej strategjive më efektive në kopsht. Mësuesi integron përvojat e të mësuarit, në mënyrë që fëmijët të kuptojnë marrëdhënien midis koncepteve të të mësuarit dhe përvojave të përditshme, si dhe si mund t'i zbatojnë ato në situata reale.

Në këtë proces fëmijët orientohen në hapësirë. Pjesëmarrja në lojë dhe krijimi atmosferave të gëzueshme, ku fëmijët jo vetëm luajnë, zbavitën, por përmirësojnë pjesëmarrjen në të nxënë. Me rëndësi në lojërat e grupit është pjesëmarrja, vendosja e rregullave dhe respektimi i tyre.

## Alternativa të tjera për zhvillim të aktivitetit:

Mund të përzgjedhim një tematikë për natyrën dhe ta gërshetojmë me konceptin e ngjyrave.

**Vështirësitë/ sfidat:** Ngjyrat janë ndër konceptet e para që fëmijët përfitojnë në kopsht. Fëmijët janë të vegjël, të ardhur për herë të parë në kopsht dhe kjo paraqet shpesh vështirësi që ata të zbatojnë rregullat. Gjatë veprimtarisë duhet të jenë dy edukatorë. Ka nevojë për materiale të ndryshme që të jenë të përshtatshme. Mjedisi duhet të jetë i përshatshëm të ketë hapësirë e duhur.





# 4

## PRAKTIKË E MIRË

KOMPETENCA	SRATEGJITË E MËSIMDHËNIES
Parimi	5.3 Edukatori/ësuesi i projekton veprimtaritë duke marrë parasysh përvojat dhe kompetencat e fëmijëve në mbështetje dhe zgjerim të mëtejshëm të zhvillimit dhe të të mësuarit e tyre
Treguesit	5.3.2 Edukatori/ësuesi ofron për fëmijët një numër të mjaftueshëm dhe efektiv të skelave sipas nevojave dhe progresit të tyre
Aktivitetet/veprimtaritë edukative	Numrat dhe numërimi
Rezultatet e të nxënit	Fëmijët dallojnë numrat. Bëjnë lidhjen e numrit gjatë numërimit me gjëra të ndryshme
Materiali i nevojshëm	Tabela e numrave 1-5; kukullat me numra; tabela me peshqit me magnet; fletat e afishuara me numra, ora lodër, dominot, Cd, letrat e bardha, lapsat, ngjyrat.....
Ndërlidhja e kompetencave	Ndërveprimi, Familja dhe komuniteti



## Parapërgatitja

Shumë fëmijë shfaqin interes e kureshtje në mosha të hershme për të shkruar, modeluar dhe punuar me numra. Ky fakt ka ndikuar që të planifikohet dhe gjendet një strategji e duhur nga edukatorët, në mënyrë që të fëmijëve të ju ofrojmë përvoja të të nxëniet për numrat dhe numrimin duke aplikuar metoda pune ndërvepruese dhe kreative. Gjatë përgatitjeve kemi pasur parasysh kohën dhe qendrat e punës ku do të zhvillohen aktivitete që kanë qëllimin e integritimit ndërfaqor, duke qenë të vetëdijshëm që fëmijët kanë dëshira, interesime dhe prirje të ndryshme. Po ashtu planifikuam veprimtaritë educative duke konsideruar veçantitë e secilit fëmijë, aktivitete e lojëra të ndryshme kreative e matematikore (gjejmë numrin duke numëruar sendet, lidhim numrin me simbolin përkatës, detyra me mbledhje dhe zbritje si dhe lojërat me zare, etj) që do të zhvilloheshin gjatë takimit të përbashkët, si edhe në të gjitha qendrat, p.sh. duke numëruar blloqet, lugët apo pirujt, librat, kukullat, pullat, gurrlecët etj. Aktivitetet e fëmijëve përcillen me teknika të ndryshme, si p.sh. rrjeti i merimangës, duke u kërkuar fëmijëve t'i numërojnë kalimet që do të bëjnë me perin, nga njëri fëmijë tek tjetri; të nxëniet në bashkëpunim, duke kërkuar bashkëpunim në grupe të vogla me nga 4-5 fëmijë. Zgjidhen mjete të lloj-llojshme, lodra të cilat i pëlqejnë më shumë fëmijët, si domino, tabela - peshqit me magnet, kukullat me numra, ora lodër, mjete didaktike si p.sh. numëratoret, lapsa, ngjyra, fleta të bardha, letra me numra, materiale të ndryshme si dhe mjete të cilat janë krijuar nga edukatorët, në mënyrë që fëmijës t'i ofrohen mundësi të shumta, por me një koherencë ndërmjet tyre, si p.sh. tabela me numra dhe gishtërinj (numrat dhe numërimi), 5 fleta të afishuara në mur, ngjyra të ndryshme të cilat përmbajnë numrat nga 1 deri në 5 të shoqëruar me topat e vizatuar në përputhje me numrin që paraqet fleta, si dhe eurot e krijuara me karton, duke filluar nga 1-5.

Pas fazës parapërgatitore, bëhet një ndarje në grupe e fëmijëve, sipas nivelit të njohjes së numrave dhe numërimit. Fëmijët ndahen në tri grupe: ata që nuk i njohin vizualisht numrat dhe nuk dijnë të numërojnë saktë, duke iu ofruar pak ndihmë; ata që dallojnë 2-3 numra por jo të gjitha dhe dijnë të numërojnë; ata që i njohin numrat dhe dijnë të numërojnë. Krijohet mundësia e ofrimit të përfshirjes së secilit fëmijë në një mjedis nxitës, bashkëpunues dhe eksplorues.

## Realizimi

Pasi është realizuar faza parapërgatitore, fillon faza e realizimit. Çdo ditë punohet me grupe të vogla, me nga 4 fëmijë. Aktiviteti fillon në qendrën e matematikës, duke u prezantuar fëmijëve ilustrime të numrave nga 1-5. Numrat vendosen sipas rradhës, në mënyrë që fëmijët të nxiten të bëjnë



lidhjen e tyre me figura që e kanë po të njëjtin numër. Ky ushtrim përsëritet disa herë në mënyrë që fëmijët të memorizojnë të paktën një numër. Vazhdohet me lojën e kukullave. Secila kukull ka një numër nga 1-5. Ato shpërndahen te fëmijët në mënyrë që të memorizohet vizualisht numri që mban shoku apo shoqja. Edhe ky ushtrim në formë loje përsëritet disa herë. Ushtrimin e ndihmojnë edhe kukullat me ngjyra të ndryshme, si: të bardhë, të verdhë, të kuqe, të kaltër të hapur dhe të kaltër të mbyllur, element i cili ndihmon që më lehtë të mbahet mend vizualisht numri. Pas realizimit të aktivitetit apo lojës në qendrën e matematikës, fëmijët nxiten të vëzhgojnë numrat e vendosur në mur, në të cilën janë të afishuara numrat që tregojnë cili është numri 1, 2 e kështu me rradhë,.... Ky ushtrim ndihmon fëmijët në memorizimin e numrave.

Në qendra tjera derisa zhvillohet tema “Bota ujore”, improvizohet një dyqan peshku, ku fëmijëtve blejnë peshqi. Në qendrën e matematikës janë përgatitur eurot, nga 1 – 5, të punuara me karton, ku secili fëmijë blen peshk me to. Fillimisht fëmija përshëndet, pyet për çmimin dhe pastaj kërkon të blejë peshkun që i pëlqen. Secili fëmijë tregon se sa euro ka, dhe nëse ai thotë që ka 4 euro, ne i themi që peshku kushton 3 euro, dhe pastaj fëmija pyetet se sa euro duhet t’i kthen. Veprimet matematikore me zbritje, mund të jenë të vështira për një pjesë të konsiderueshme të fëmijëve, por ka edhe fëmijë që duke u menduar pak, arrijnë të japin përgjigje të saktë. Me kalimin e kohës këto detyra, ndonëse bëhen të zakonshme, zbavitëse për fëmijët duke i numruar gjësendet tjera që ndodhen në dhomë. Ndhimë të madhe bëjnë tabela me numra dhe gishtërinjë, pasi përveç aspektit vizual, bën të mundur që fëmija të bëjë lidhjen që ekziston mes numrit dhe numërimit. Fëmijëve, u shpjgohet kjo tabelë, një gisht lidhet me numrin 1, dy gishta me numrin 2, e kështu me rradhë.

Në qendrën e blloqeve, gjithashtu, kërkohet që fëmijët të sjellin p.sh. 3 blloqe me ngjyrë të verdhë. Fëmijët, fillimisht i numërojnë me zë të lartë dhe pastaj i kanë sjellë për t’i parë të gjithë. Në qoftë se ndonjë fëmijë ka gabuar, menjëherë është përmirësuar nga fëmijët e tjerë. Po ashtu edhe në qendrën e familjes, me kukulla, lugë, pirunë , etj. bëhet numërimi, gjë që me kalimin e kohës ka dhënë rezultat.

## Reflektimi

Për zhvillimin e aktivitetit marin pjesë të gjithë fëmijët e grupit duke u përkrahur në aktivitetet që ata kanë nevojë për nxitje dhe inkurajim. Duhet të theksohet që metodologjia e punës është mjaftë efektive, në mënyrë të veçantë - rrjeta e merimangës, me anë të së cilës kërkohet që fëmijët të numërojnë kalimet nga njëri fëmijë tek tjetri. Një pikë e fortë dhe efektive është të nxënit në bashkëpunim, sepse për të ndihmuar fëmijët që nuk i njohin vizualisht numrat, dhe nuk arrijnë të numërojnë saktë,



bashkëpunohet me fëmijët që i njohin pak më mirë ose i njohin shumë mirë numrat dhe numërimin, në mënyrë që të prfitojnë fëmijët e tjerë që t'i fitojnë ose t'i saktësojnë këto njohuri. Një element, i cili është i nevojshëm të theksohet, është fakti që i gjithë procesi i të nxënit realizohet në atmosferë loje, gjë që nxit kureshtjen e fëmijëve për argëtim dhe përfitim të njohurive të reja.



# 5

KOMPETENCA	SRATEGJITË E MËSIMDHËNIES
Parimi	5.3 Mësuesi /edukatori harton veprimtari duke marrë parasysh përvojat dhe kompetencat e fëmijëve në mbështetje dhe zgjerim të mëtejshëm të zhvillimit dhe të mësuarit e tyre.
Treguesit	5.3.2 Edukatori/mësuesi ofron për fëmijët një numër të mjaftueshëm dhe efektiv të skelave sipas programit dhe përvojave të tyre. 5.3.4 Edukatori /mësuesi integron përvojat e të mësuarit, në mënyrë që fëmijët të kuptojnë marrëdhënien midis koncepteve të të mësuarit dhe përvojave të përditshme, si dhe si mund t'i zbatojnë ato në situata reale.
Aktivitetet/veprimtaritë edukative	Njohim të kaluarën tonë
Rezultatet e të nxënit	Njohin zakonet, traditat dhe kulturën e popullit shqiptar Dallojnë zakonet e veçanta të popullit shqiptar, Analizojnë veshjet, muzikën, instrumentet, orenditë shtëpiake etj nga e kaluara Krahasojnë traditën e popullit shqiptar me praktikat e sotme Vlerësojnë të kaluarën e popullit shqiptar Shkruajnë dhe njohin numrin 5 Krijojnë fjalë e fjali me kontekst kombëtar (zgjerojnë fjalorin) Krijojnë libëra në bashkëpunim me shokët
Materiali i nevojshëm	Plis, veshje kombëtare, çifteli, enë të drunjta, sofër, flamur kombëtar,
Ndërlidhja e kompetencave	Ndërveprimi, Planifikimi dhe vlerësimi



## Faza I- Parapërgatitjet

Njohja e vetvetes dhe krijimi i identitetit kombëtar është njëri nga qëllimet primare të Kurrikulës së re të Kosovës. Fëmijët duhet të njohin karakteristikat e popullit të cilit i takojnë duke hulumtuar të kaluarën përmes bisedave me shokë, mësuese/edukatore, me gjyshër, prindër dhe me mbarë komunitetin që i rrethon. Fëmijët janë kurioz për të bërë pyetje për të kaluarën dhe kjo kureshtje duhet përkrahur e zhvilluar edhe pse po jetojmë në kohën e ndërkombëtarizmit dhe europianizimit, sepse njeriu duhet njohur e dashur fillimisht veten dhe pastaj të tjerët.

Edukatorët në javën para se të fillojë ky aktivitet filluan grumbullimin dhe sigurimin e materialeve të nevojshme për të zhvilluar aktivitetin me sukses. Ato bënë një listë me materiale të cilat flasin për kulturën, traditën dhe zakonet kombëtare. Listën e ndanë me prindërit e kopshtit të cilët u informuan për qëllimin e aktivitetit dhe i'u kërkua që të ndihmojnë aktivitetin me gjëra që mund t'i kenë në shtëpi. Nëse në klasë/dhomë, ka fëmijë të komuniteteve të tjera, u inkurajuan edhe ata që të sjellin materiale të ngjashme në mënyrë që të bëhen krahasime, të njohin njëri-tjetrin dhe mos të ndihen të diskriminuar.

Edukatorët përgatitën në letra të mëdha katër ilustrime dhe përgatitën një tregim për fëmijët. Në ilustrimin e parë ato vizatuan: Dy fëmijë duke vrapuar për të përqaftuar gjyshin tyre. Gjyshi është i veshur me veshje kombëtare (kosovare) mbanë një plis në kokë, ndërsa ambienti përreth i ngjanë një oborri me një shtëpi të vjetër (kullë) tipike shqiptare. Gjyshi paraqitet duke mbajtur plisin me dorë, ndërsa edukatorët sqarojnë se ai po i'u flet fëmijëve për plisin dhe prejardhjen e tij.

Gjyshi ka studijuar për histori dhe ai e njeh shumë mirë të kaluarën tonë. Fëmijët duan që të mësojnë shumë nga gjyshi. Ata nuk ndalen duke i bërë i pyetje të ndryshme. Edhe gjyshi me shumë kënaqësi, bisedon me ta. Sapo fëmijët u përqaftuan me gjyshin, vajza kureshtare filloi me pyetjet e saja që kurrë nuk përfundojnë. Ajo pyeti gjyshin se përse ai mbanë në kokë vazhdimisht një kapele të bardhë dhe mjaft të veçantë.

Gjyshi i tregoi fëmijëve se populli shqiptar i ka zakonet, traditat dhe kulturën mjaft të veçantë. Ne, filloi të tregojë gjyshi, jemi popull shumë i lashtë, kemi qenë në këto troje gjithmonë, askush nuk mbanë mend e as nuk shkruan se ne kemi ardhur nga një vend tjetër. Jemi ne shqiptarët me këtë tokë, si mishi me thua. E këtë kapele ne e qujamë plis, është dicka që na ka dalluar prej popujve të tjerë sepse askush nuk mbante një kapelë të bardhë përveq të parëve tanë pellazgë e ilirë.

Plisi punohet nga leshi i deles së bardhë, prej ketu i mbeti edhe emri, pi-leshi ose pi-lesi, plesi, plisi.

**Ilustrimi 2.** Gjyshi duke u'a vendosur fëmijëve nga një plis në kokë.

**Tregimi i edukatores:** Edukatorja u tregon fëmijëve bisedën midis gjyshit dhe fëmijëve: Sa bukur më rri plisi gjysh. A mund ta marr plisin në kopsht/shkollë gjysh? Do t'ua tregoj gjithë shokëve dhe shoqeve. Do t'u tregoj edhe përse quhet plis. Vajzës I pëlqeu shume edhe xhamadani kuq e zi që kishte veshur gjyshi. Ajo kishte shumë dëshirë të kshite një xhamadan të tillë.

**Ilustrimi 3.** Djali me plis në kokë me një fytyrë të habitur shikon lartë në qiell një shqiponjë duke fluturuar.

Ai pyet gjyshin çfarë është ai zog kaq i madh dhe që po fluturon kaq bukur në qiell.

**Teksti poshtë ilustrimit:** Lumi i habitur nga bukuria e një zogu të bukur me shumë kureshtje pyeti gjyshin se çfarë zogu po fluturon mbi ta. Gjyshi Sokol, mezi priste tu tregonte fëmijëve për shqiponjën e bukur që po hidhte valle në këtë ditë të bukur. Lum lumi- ajo është një shqiponjë. Shqiponjat hedhin këso valle të bukura në qiell dhe nga lartë vëzhgojnë zogjtë e vet që iruajnë si sytë e ballit e në anën tjetër shikojnë të gjejnë edhe ushqimin për ta.

Shqiponja nuk i braktis asnjëherë zogjtë e vet. Ajo është bashkë me ta derisa të rriten e të fluturojnë vet në qiellin e lirë.

Ne shqiptarët ngajmë shumë me shqiponjat, ne e kemi edhe emrin e njëjtë. Shqiptari dhe shqiponja. Shqiponja është simboli ynë kombëtar... Flet gjyshi Sokol duke shikuar shqiponjën tek fluturon e lirë në qiell.

Gjyshi vazhdon t'u tregojë fëmijëve për simbolin e kombit shqiptar. Ai nxorri nga xhepi një flamur të vogël kuq e zi dhe ua tregoi Veses dhe Lumit. Shikoni fëmijë, e keni parë ju se në flamurin tonë kombëtar është shqiponja, por, kjo është me ndryshe, është me dy koka. Kjo shqiponjë është shumë e veçantë, ajo është edhe më e kujdesshme, ajo shikon e ruan trojet shqiptare me të dy kokat e saj, majtas dhe djathtas. Ajo mbronë shqiptarët sikur shqiponja, zogjtë e saj.

**Ilustrim 4:** Fëmijët në oborrin e gjyshit, duke luajtur me pulat, gjyshi duke nxjerrë ujë me kovë nga pusi. Gjyshja e veshur me veshje dukagjini, duke gatuar një pite mbi një sofër druri. Disa elemente kuzhine te drunjta mbi sofër. Anash një djalosh që i bie çiftelisë. Nga dera e hapur e odës vërehet një ambient i idës tipike shqiptare. Çilimi kuq e zi në tokë, shpuza për tu ulur, një oxhak i ndezur...

**Teksti:** Gjysh, gjysh, pyet vajza. Po ai xhaxhi ku e mori atë kitarën e çudishtme me dy tela? Kush ia ka këputur telat e tjerë? E gjyshi Sokol me buzë në gaz i bashkangjitet këngës së xhaxhit Bardhosh...

**Teskti:** Xhamadani vija vija, është Kosova është Shqipëria

Xhamadani kuq e zi, jemi të lumtur unë dhe ti!

Edukatorët përgatitën edhe fleta pune për qendrat e artit. Leximi-shkrimit dhe të matematikës.



## Faza 2- Përshkrimi i realizimit të aktivitetit

Edukatorët e filluan javën me ilustrimin e parë nga tregimi i përgatitur më parë. Ato hapën diskutimin gjatë takimit të mëngjesit duke i'u bërë fëmijëve pyetje për ilustrimin në mënyrë që të njihen me nivelin e informimit që fëmijët kanë paraprakisht. Edukatorët bënë pyetje si: Ku kanë shkuar fëmijët? Çfarë ka veshur gjyshi? A keni qenë dhe ju në një vend të tillë? A keni parë veshje të tilla? Çfarë veshje janë këto? Po në kokë çfarë ka gjyshi? Si quhet kjo kapele?

Edukatorët më pas filluan të tregojnë ngjarjen vazhdimisht duke bashkëbiseduar me fëmijët. Fëmijët shpesh ndërprejnë edukatorin ndërsa ajo zgjeronte diskutimin varësisht nga kureshtja që fëmijët kishin për të bërë pyetje.

Për katër ditë rradhazi, edukatorët filluan takimin e mëngjesit me ilustrimet e përgatitura dhe tregimi vazhdonte sipas rrjedhës së përgatitur. Edukatorët bënë pyetje të hapura para se të fillonin tregimin e përgatitur. Ato pyesnin fëmijët:

Çfarë dinë për shiponjën? A fluturon shpejt? A kujdeset mirë për zogjtë e saj? A i mbronë ata nëse dikush tenton t'u bëj diçka të keqe? Si i mbronë ata? Çfarë kemi të përbashkët me shqiponjën? Si quhet instrumenti që ka në dorë xhaxhai? Po të tjera instrumente që përdorin shqiptarët cilat janë? Si duket dhoma në fshat? Çfarë ushqimesh tradicionale njohin ata dhe që i kanë ngrënë? Çfarë ka veshur gjyshja? Etj.

Pas takimit të mëngjesit, edukatorët ndajnë fëmijët nëpër qendra duke punuar sipas qëllimit dhe rezultateve të të nxënies të planifikuara për çdo ditë.

Në **qendrën e artit**: Në ditën e parë fëmijët vizatuan plisin dhe e prenë me gërshërë. Ditën tjetër fëmijët ngjyrosën fytyra të qeshura të djemve dhe vajzave në fleta A4 dhe ua vendosën plisat mbi kokë. (Fëmijët me plisa u vendosën në murin e dhomës). Ditën tjetër, fëmijët ngjyrosën flamurin kombëtar i vendosën një shtizë përmes pipëzave plastike dhe i vendosën lartë mbi raftet. Edukatorët u treguan fëmijëve se flamuri duhet respektuar dhe ai nuk lihet në tokë ose diku ku mund të dëmtohet. Ditën e katërt fëmijët në qendrën e artit ngjyrosën në fleta pune enë dhe mjete të tjera të punës, nga tradita jonë. Ata i dizajnuan modelet e tyre sipas dëshirës. Një ditë më vonë, fëmijët vizatuan çiftelinë, dairen, lahutën, fyellin, i ngjyrosën ato dhe i prenë me gërshërë. Në ditën e fundit të javës, fëmijët krijuan kopertinat e librit të instrumenteve muzikore tradicionale dhe të enëve e mjeteve të punës. Edukatorët u ndihmuan fëmijëve të shkruanë titullin e librit (secili libër emrin e një instrumenti, ndërsa në faqet e librit instrumentet e përgatitura nga fëmijët një ditë më parë) psh. Libri "Çiftelia", "Lahuta" etj. Në kopertinë fëmijët shkruan emrat e tyre si autorë të librit.

Në **qendrën e matematikës**: Në ditën e parë, eduktoret kishin përgatitur një fletë pune, ku fëmijët do të krijojnë bashkësi me nga 5 elemente. Ata do të rrethoni me laps, 5 plisa, 5 flamuj, 5 shqiptonja, 5 shqiptarë të veshur në veshje kombëtare, 5 enë druri të vjetra, 5 lugë, etj...Ditën e dytë fëmijët ngjyrosën 5 xhamadanë dhe shkruan numrin 5. Ditën tjetër fëmijët ndërton me lego një fole për zogjtë e shqiptarë ata vendosën në fole 5 zogj të bërë nga legot. Ditën e katërt fëmijët krahasuan në një fletë pune kullat shqiptare për nga lartësia, cila ishte më e lartë do të rrethohej me laps, cila më e shkurtë nuk do të rrethohej, në fletë pune kishte edhe objekte të tjera nga tradita jonë, si enë ose mjete pune, fëmijët do të rrethonin atë që është më e madhe, më e gjerë, më e gjatë etj. Në ditën e fundit fëmijët zgjedhën disa problema me mledhjen dhe zbritjen e gjësendeve tradicionale shqiptare në një fletë pune të përgatitur nga eduktoret.

Në **qendrën e shkrim-leximit**: Në ditën e parë fëmijët rikomentuan ilustrimin e përgatitur nga edukatorja. Ata krijojnë fjali ndërsa edukatorja u bënte pyetje dhe përgjigjet i shkruante poshtë ilustrimit. Në fund të fjalisë edukatorja shënonte emrin e fëmijës që thoshte fjalinë. Çdo ditë fëmijët ritregonin me fjalët e tyre ilustrimet e përgatitura. Në ditën e fundit, edukatorja kishte vendosur mbi tavolinë fleta A4 me fjalët PLIS, SHQIP, MAL, LIS, FLIA, ENA, GJYSH, GJYSHE, FLAMUR, KOMB, etj. Fëmijët krijojnë fjalët me shkronja plastike ose shkronja letre duke i renditur një nga një sipas modelit të dhënë.

Në **qendrën e shkencës**: Eduktoret kishin krijuar një kënd etnografik me të gjitha materialet e sjellura nga prindërit. Fëmijët qëndronin të lirë duke vëzhguar, analizuar, emërtuar të gjitha ato që ishin ekspozuar. Në ballë qëndronin flamuri kombëtar dhe ai shtetëror dhe hartat e Kosovës dhe Shqipërisë ishin vendosur në mur.

Në **qendrën e familjes**: Fëmijët shikojnë albume të fotografive nga e kaluara. Dramatizojnë raportet familjare duke gatuar ushqime, përgatisin sofrën për të ngrënë, pastrojnë enët, munësisht, veshin dhe zhveshin veshje kombëtare të sjellura nga prindërit.

Në ditën e premte eduktoret kishin planifikuar dhe dërguan fëmijët në muzeun etnologjik të Kosovës në Prishtinë.

Gjatë ditës në dhomë dëgjohej muzikë popullore me zë të ulët ndërsa në fund të ditës fëmijët inkurajoheshin të vallëzonin valle të përbashkët ose në dyshe. Fëmijët mbanin shami të kuqe në duar.



### Faza 3: Reflektimi

#### Alternativa të tjera për zhvillim të aktivitetit:

Rregullimi i ambientit/dhomës gjatë gjithë javës të ketë pamje me motive tradicionale (çilima në tokë, shpuza për t'u ulur, plisa në koka të fëmijëve, veshje kombëtare etj.

#### Vështirësitë/ sfidat:

Vështirësitë e realizimit të këtij aktiviteti/projekti ishte sigurimi i materialeve tradicionale. Gjatë realizimit dhe sidomos gjatë planifikimit kërkohet angazhim i dy edukatoreve në përgatitjen e fletave të punës.





# Kompetenca 6-1



# 1

KOMPETENCA	MJEDISI MËSIMOR
<b>Parimi 6.3</b>	Edukatori/mësuesi siguron një mjedis që nxit tek fëmijët ndjenjën e komunitetit dhe menaxhimin pjesëmarrës të sjelljeve të fëmijëve.
<b>Treguesi/t 6.3.1</b>	Edukatori/mësuesi komunikon pritshmëri të qarta për sjelljen dhe përfshin fëmijët në krijimin e rregullave kur duhet.
<b>Aktivitetet/veprimtaritë edukative</b>	Rregullat dhe mirësjellja
<b>Rezultatet e të nxënit</b>	Merr më shumë përgjegjësi për fjalët, sjelljet dhe veprimet e veta Respekton radhën gjatë bisedës në grup, luan lojëra me rregulla, lexon ilustrime fotografi dhe materiale të ndryshme, emërton rregulla të ndryshme krijon shenja e simbole të ndryshme në mjedisin e afërt.
<b>Materiali i nevojshëm</b>	Ilustrime për sjellje të drejta, hamer, fleta të bardha, ngjyra,libri me tregimin “Më fal,të lutem, faleminderit”, ngjitës, gërshërë, letër plastifikimi, makina për plastifikim, maketa, ilustrime të shenjave të komunikacionit, material reciklues
<b>Ndërlidhja e kompetencave</b>	Përfshirja, diversiteti dhe vlerat demokratike, planifikimi dhe vlerësimi, ndërveprimi.



## Faza 1 - Parapërgatitjet

Për ta realizuar temën së pari nevojitej t'i njoftojmë prindërit për temën e caktuar, prandaj i ftuam në takim in e përbashkët.

Të gjithëve prindërve u pëlqeu tema dhe morën vendim që fëmijët të bëjnë një demonstrim të rregullave në trafik. Kjo u realizua me ndihmën e policisë së Kosovës e cila erdhi në kopsht dhe ua shpjegoi se cilat ishin rregullat e trafikut.

Kërkuam nga prindërit që këto ditë në shtëpi të flasin për rregullat dhe mirësjelljen në përgjithësi, si në familje, në dyqane, në rrugë.

Paraprakisht kemi përgatitur disa nga materialet e nevojshme për realizimin e aktivitetit.

## Faza 2 – Realizimi

Me ndihmën e një kënge fëmijët ftohen në takim in e përbashkët. Fillojmë me rutinën ditore, ku fëmijët e plotesojnë kalendarin ditor dhe atë meteorologjik. Edukatorja fillon ta lexojë tregimin e imagjinuar, me fjalët: Të lutem, më fal, faleminderit dhe e ndërlidhë atë me komunikacion. Edukatorja merr mendimin e fëmijëve se kur përdoren këto fjalë. Përmes këtij tregimi vijmë deri tek tema ditore që kemi.

Më pas edukatorja prezanton mysafirin në klasë i cili është një polic. Ai kishte përgatitur për fëmijët që të diskutonte rregullat dhe disa shenja të komunikacionit si: shenjën stop, semaforin, kalimi i këmbësorëve në vija të bardha etj. Fëmijët kishin shumë pyetje, si për uniformë, sa orë punojnë, e po ashu edhe për dënimet. Më pas me ndihmën e policit, në rrugën afër kopshtit demonstruam kalimin e rrugës. Biseduam për vendkalimin, rregullat e ndryshme kur guxojmë të kalojmë rrugën, të shikuarit së pari djathtas e pastaj majtas si dhe t'i falenderohemi vozitësit që na e liroi rrugën.

Me ndihmën e policit dhe edukatoreve fëmijët kaluan disa herë rrugën dhe demonstruan rregullat dhe mirësjelljen. Më pas falenderuam policin dhe u kthyem në dhomë ku vazhduam diskutimin në grup të madh.

Edukatorja vazhdoi me pyetje të hapura: A thua çka do të ndodhte në komunikacion po të mos kishte semafor? Fëmijët japim mendimet e tyre dhe përmendin, tollovinë, ndeshjet, vonesat e të tjera arsye që mund të ndodhin në trafik në këso raste. Më pas edukatorja vazhdoi me pyetje tjera si: Nëse ka rregulla, a mund të veprojmë edhe pa semafor? Si duhet të sillemi? Kishte fëmijë që

mendonin se trafiku mund të funksionojë edhe pa semafor dhe kishte fëmijë që mendonin se nuk bën. Pastaj edukatorja orienton pyetjet nga shtëpia. A keni rregulla në shtëpi? Kush i ka formuar rregullat në shtëpi? A i respektoni rregullat në shtëpi? Cilat janë rregullat që i keni në shtëpi? Përgjigjet janë të ndryshme, Lindi përmend se kur bashkohen akrepat (20:40) ai shtrihet të flejë, Liza tregon se pjatën e vet e largon nga tavolina pas ngrënjes, ndërsa Beni tha se para gjumit gjithnjë prindërit kërkojnë që të lajë dhëmbët, Dita tha se në telefon mund të luajë vetëm 20 min, pastaj mami e largon telefonin sipas rregullit që kemi caktuar

Pas kësaj edukatorja parashtron pyetje për rregullat në klasë/dhomë.

Cilat janë rregullat e grupit?, Si duhet të sillemi? A duhet t'i respektojmë rregullat? A na ndihmojnë rregullat që ne të jemi të sjellshëm dhe të sillemi me edukatë? Sa rregulla duhet të kemi në grup? Kush i formon ato ? Cilat janë ato? Ku do t'i vendosim rregullat. Kështu edhe fillojnë të hartohen rregullat e klasës/grupit. Edukatorja mban shënime Përmes këtyre pyetjeve fillojmë të diskutojmë në rreth dhe në bazë të diskutimeve fillojmë t'i shkruajmë rregullat e reja . Disa nga rregullat që i vendosëm ishin: të respektojmë njëri- tjetrin kur flet, të flasim me radhë, të sillemi me mirësjellje, të përdorim fjalët magjike faleminderit, të lutem, më fal të ndihmojmë njeri tjetrin kur ka nevojë, t'i pastrojmë duart para dhe pas ushqimit, pas lojës t'i vendosim në vende lodrat dhe mjetet, të kujdesemi për librat etj.

Më pas të gjithë së bashku shënuam dhe vizatuam rregullat në fleta me ngjyra. Pasi që përfunduam, kërkua nga fëmijët të japin mendime se çka do të ndërmarrim po qe se rregullat nuk respektohen. Vendosëm së bashku që një javë do të kemi kohë që t'i mësojmë rregullat, ashtu që secili ka për detyrë të vëzhgojë dhe të përcjell respektimin e rregullave.

Në fund së bashku punuam dhe ngjyrosëm fletët me rregulla të shkruara të cilat i vendosëm në mur, afër hapësirës ku zhvillohet takimi i përbashkët.

### **Këndëvështrimi i fëmijës/ prindit:**

Të nesërmen pas zhvillimit të aktivitetit një fëmijë ka treguar që edhe ajo i ka bërë disa rregulla në shtëpi së bashku me prindërit.

